



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA

Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se **Buletini nr. 129** i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 05.05.2018 deri më 19.05.2018.

Tetovë, më 05.05.2018

Zyra për çështje juridike



Drejtuar:

Këshillit të Rektoratit të

Universitetit të Tetovës

Tetovë

R E F E R A T

për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët E drejta civile (pjesa e përgjithshme) dhe E drejta e shoqërive në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës www.unite.edu.mk dhe në gazetën ditore “Koha” dhe “Veçer” me datë 31.01.2018, për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Docent** për lëndët: **1. E drejta civile (pjesa e përgjithshme) dhe 2. E drejta e shoqërive** në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, me Propozim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik nr. 13-178/3 të datës 20.02.2018 dhe me Vendim të Këshillit të Rektoratit nr. 02-1136/1 të datës 06.03.2018 formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Agim Nuhiu, kryetar**
- 2. Prof. Dr. Bashkim Selmani, anëtar**
- 3. Doc. Dr. Afet Mamuti, anëtar**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenet 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsim Sipëror (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve dhe asistent-doktorantëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

RECENSION

Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës me datë 30.01.2018 në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës www.unite.edu.mk dhe në gazetën ditore “Koha” dhe “Veçer”, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: 1. E drejta civile (pjesa e përgjithshme) dhe 2. E drejta e shoqërive në thirrjen mësimore-shkencore Docent, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, u paraqit kandidati i vetëm Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi.

I. Të dhëna biografike të kandidatës Dr.sc. Shpresa Alimi-Memedi

1. Arsimimi

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi ka lindur më 29.09.1981 në Tetovë, Republika e Maqedonisë. Shkollimin fillor e ka kryer në Sh.F. “Istikbal” në Tetovë. Paralelisht e ka kryer edhe shkollën fillore të muzikës në drejtimin e pianos në Shkollën Shtetërore të Muzikës “Todor Skalovski Tetoe” në Tetovë. Me sukses të shkëlqyeshëm e ka kryer shkollën e mesme në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç” në Tetovë në vitin 1999. Në vitin 2001 regjistrohet në Fakultetin Juridik pranë Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë, ku në gusht të vitit 2005 i mbaron studimet me notë mesatare 9.51, si student i dalluar në gjeneratën e saj, dhe e merr titullin Jurist i Diplomuar. Menjëherë pas kryerjes së studimeve deridiplomike, nga data 15.08.2005 e deri më 01.11.2005 angazhohet si praktikant në Gjykatën Themelore në Tetovë.

Në vitin 2007 regjistrohet në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, Republika e Kosovës, në drejtimin juridiko-civil. Provimet e magistraturës i përfundon me notë mesatare 9.25. Më 11.02.2010, e mbron temën e magistraturës me titull: “Pavlefshmëria e kontratave me vështirësi të posaçëm në Ligjin mbi marrëdhëniet detyimore të Republikës së Maqedonisë”, para Komisionit treantaresh në këtë përbërje: Prof. Dr. Abdulla Aliu (mentor), Prof. Dr. Hamdi Podvorica (kryetar) dhe Prof. Dr. Iset Morina (anëtar), dhe merr gradën shkencore Magjistër i shkencave juridike. Diploma nr. 133 e lëshuar më 31.05.2010, nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës, në Republikën e Maqedonisë është njohur me vendim të Ministrisë së arsimit dhe shkencës për njohjen e kualifikimit të arsimimit të lartë të fituar jashtë vendit, nr. 09-6978/2, të datës 29.09.2010.

Kandidatja në vitin 2011 regjistron studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik “Justinijani i Parë” të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, në drejtimin juridiko-civil, me udhëheqës shkencor Prof. Dr. Jadranka Daboviq-Anastasovska. Me vendim nr. 02-1277/46 të Këshillit mësimor-shkencor të Fakultetit Juridik, i pranohet tema e disertacionit të doktoraturës: “Начелото на автономија на волјата на договорните страни во договорното право на Република Македонија и во европското договорно право” (Parimi i autonomisë së vullnetit të palëve kontraktuese në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë dhe në të drejtën kontraktore evropiane”. Disertacionin e doktoraturës kandidatja e mbron më 06.11.2017 para Komisionit në këtë përbërje: 1. Prof. Dr. Gale Galev (kryetar), 2. Prof. Dr. Jadranka Daboviq-Anastasovska (mentor), 3. Prof. dr. Rodna Zhivkovska (anëtar), 4. Prof. Dr. Neda Zdraveva (anëtar) dhe 5. Prof. Dr. Nenad Gavriloviq (anëtar), me çrast kandidatja fiton titullin shkencor Doktor i Shkencave Juridike.

2. Përvoja universitare

Kandidatja Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi ka kontinuitet në përvojën e saj universitare. Menjëherë pas diplomimit, duke filluar nga viti 2005, është e kyçur në procesin arsimor në nivel universitar. Duke filluar nga 01.11.2005 deri më 31.10.2007 është pranuar në marrëdhënie pune si asistent i ri në grupin e lëndëve civile në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë.

Më 16.10.2007 me vendim të Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës (Vendimi nr. 04-1458/17 të datës 16.10.2007), kandidatja zgjedhet bashkëpunëtor në thirrjen asistent i ri në fushën e së drejtës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

Më 09.11.2012, me vendim të Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës (Vendimi nr. 04-1940/1 të datës 04.04.2013), kandidatja zgjedhet bashkëpunëtor në thirrjen asistent në fushën e së drejtës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.

II. Veprimtaria mësimore-arsimore

1. Mbajtja e mësimit (ushtrime dhe ligjërata)

Gjatë periudhës së angazhimit si asistent i ri në grupin e lëndëve civile në Fakultetin Juridik të Universitetit të Evropës Juglindore në Tetovë ka mbajtur ushtrimet nga lëndët: E drejta civile, E drejta sendore, E drejta kontraktore, E drejta e procedurës civile, E drejta civile krahasuese, E drejta e punës dhe e sigurimit social, Sociologjia e së drejtës, Filozofia e së drejtës, si dhe ka qenë ligjëruese e lëndëve (nën mentorim): Studime evropiane, Inzhinieringu juridik III dhe Inzhinieringu juridik IV.

Gjatë periudhës së angazhimit si bashkëpunëtor në thirrjen asistent i ri në fushën e së drejtës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës dhe më vonë bashkëpunëtor në thirrjen asistent në fushën e së drejtës, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës në Tetovë ka mbajtur ushtrimet dhe ligjerata (nën mentorim) në lëndët: E drejta civile (ligjerata dhe ushtrime), E drejta sendore (ushtrime), E drejta detyrimore (ushtrime), E drejta e shoqërive (ushtrime), E drejta e procedurës civile (ushtrime), E drejta romake (ushtrime), E drejta finansiare (ushtrime) si dhe E drejta e autorit (ligjerata dhe ushtrime). Në Fakultetin Juridik të disperzuar në Kërçovë ka mbajtur ligjerata (nën mentorim) dhe ushtrime në lëndët: E drejta sendore dhe E drejta familjare, ndërsa në Fakultetin e Administratë së Biznesit ushtrime në lëndën E drejta afariste. Duke filluar nga viti akademik 2011/2012 deri në vitin akademik 2017/2018, në Fakultetin Juridik të disperzuar në Shkup ka mbajtur ligjerata (nën mentorim) dhe ushtrime në lëndët: E drejta civile, E drejta sendore, E drejta e shoqërive, Terminologjia juridike, E drejta e procedurës civile dhe ushtrime në lëndën E drejta romake. Numri semestrave në të cilët janë realizuar ligjeratat dhe ushtrimet përkatëse mund të shihet nga shtojca e këtij referati.

2. Skriptë interne nga ligjëratat

Kandidatja për nevojat e studentëve në lëndën “E drejta e autorit” ka përgaditur skriptë interne me titull: “E drejta e autorit (Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqëta i Republikës së Maqedonisë), Material plotësues për përgaditjen e provimit nga lënda “E drejta e autorit””, Tetovë, 2017.

3. Mentorim në mësim praktik

Kandidatja nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës ka qenë e caktuar mentor për mësim praktik të studentëve të vitit të tretë (studimet e disperzuar në Shkup) në Gjykatën Themelore Shkupi I-Shkup dhe në Komunën e Çairit, organizuar në vitet akademike 2016/2017 dhe 2017/2018.

II. Veprimtaria hulumtuese-shkencore

Kandidatja Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi gjatë periudhës së angazhimit në mësimdhënie merret me punime në fushën e së drejtës civile:

1. Pjesëmarrje në projekte

Projekt hulumtues-shkencor të miratuar dhe finansuar nga Ministria e kulturës së Republikës së Maqedonisë, në kuadër të Programin vjetor të Ministrisë së kulturës për projekte me interes nacional në kulturë për vitin 2018 sipas veprimtarive dhe lëmive, nga cili në botim është monografia me titull: “Начелото на слобода на договарање во француското и германското право”, Shkup, 2018.

2. Monografi

Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi, “Начелото на слобода на договарање во француското и германското право”, Shkup, 2018.

3. Punime shkencore

1. Shpresa Alimi-Memedi, *Формализмот во македонското договорно право*, Knowledge International Journal, ISSN 1857-923X, Global Impact & Quality Factor 1.322 për vitin 2016, Vol. 22/2018, Shkup, 2018, Botim nga Sixteenth International Scientific Conference, Topic: Knowledge without borders, organizuar nga Institute of Knowledge Management, Vrnjačka Banja, Republika e Sërbisë, 15, 16, 17 dhe 18 Mars 2018;

2. Shpresa Alimi-Memedi, *Автономија на волјата на договорните страни и нејзините општи граници во Законот за облигационите односи на Република Македонија*, Centrum - International Scientific Journal, ISSN: 1857-8640 (Print), ISSN: 1857-9396 (Online), UDC 3(497.7:4-672 EU), Global Impact & Quality Factor 0.784 për vitin 2016, No. 8/2017, Shkup, 2017, qasje në: <http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/12/PJESA-21.pdf>.

3. Shpresa Alimi-Memedi, *Freedom of contract and consumer protection in the Directive 93/13/ECC on unfair terms in consumer contracts and the Directive 2011/83/EU on consumer rights*, në botim në Iusticia (Revistë Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, në botim në Vol. 6, Nr. 8, Tetovë, 2018, botim nga Konferenca e Katërt Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Juridik: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017;

4. Shpresa Alimi-Memedi, *Pazotësia e veprimit si shkak për nulshmërinë e kontratave në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë*, The Heritage, ISSN 1857-7482, No. 2/2015, Strugë, 2015, qasje në: <http://www.eust.edu.mk/Heritage/files/SCfSD15.pdf>, botim nga Konferenca e Dytë Ndërkombëtare Shkencore: Scientific Challenges for Sustainable Development, Organizera: International University of Struga (IUS), Book of Proceedings, Struga, 17, 18, 19, April 2015;

5. Shpresa Alimi-Memedi, *Autonomia e vullnetit të palëve nga feudalizmi në bashkëkohësi*, Vizione (Revistë ndërkombëtare për shkencat shoqërore), ISSN 1409-8962-printed form, ISSN 1857-9221-electronic form, Nr. 23/2015, Shkup, 2015, qasje në: <http://visionsmagazine.org/visions-magazine-issue-no-23/>;

6. Shpresa Alimi-Memedi, *Origjina e autonomisë së vullnetit të palëve kontraktuese dhe zhvillimi i saj në të drejtën romake*, Iusticia (Revistë Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, Nr. 1/2014, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2014;

7. Shpresa Alimi-Memedi, *Autonomia e vullnetit dhe kufijtë e saj në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë*, Iusticia (Revistë Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, Nr. 1/2013, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2013;

8. Shpresa Alimi-Memedi, *Nulshmëria e kontratave në Ligjin mbi marrëdhëniet detyrimore të Republikës së Maqedonisë*, Ulpianus-Revistë shkencore dhe profesionale për drejtësi e shoqatës së juristëve shqiptarë të Republikës së Maqedonisë, ISSN 1857-8144, Viti 2, Nr. 2 (2012), Tetovë, 2012;

9. Shpresa Alimi-Memedi, *Çështja e ekzistimit të punëve juridike joekzistuese*, Përmbledhje e punimeve shkencore nga Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Juridike, Shoqata e juristëve shqiptarë të Maqedonisë, ISBN 9989-2725-7-8, Tetovë, 15 Dhjetor 2008.

4. Abstrakte të botuara në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare

1. Shpresa Alimi-Memedi, *Freedom of contract and consumer protection in the Directive 93/13/ECC on unfair terms in consumer contracts and the Directive 2011/83/EU on consumer rights*, Libri i abstrakteve nga Konferenca Ndërkombëtare-Shkencore Juridike: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, ISBN 978-608-217-064-0, 17 dhe 18 Nëntor, 2017;

2. Shpresa Alimi-Memedi, *Dëmtimi tejmasë në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë*, Libri i abstrakteve nga Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Juridike: Drejtësia dhe sfidat e proceseve euro-atlantike, ISBN 978-608-217-048-0, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 18 dhe 19 Nëntor, 2016;

3. Shpresa Alimi-Memedi, *Capacity to act of legal persons with special emphasis on harmonization of Macedonian Contract Law with European Union Law*, Libri i abstrakteve nga Konferenca Shkencore Ndërkombëtare: Mendimi shkencor juridik në botën e integrimi dhe globalizimit, ISSN: 1857-8144, Shoqata e juristëve shqiptarë të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 25 Nëntor 2012.

5. Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare shkencore dhe simpoziume

Kandidatja ka qenë pjesëmarrëse në konferencat në vijim:

1. Sixteenth International Scientific Conference Topic: *Knowledge without borders*, organizuar nga Institute of Knowledge Management, Vrnjacka Banja, Republika e Sërbisë, 15, 16, 17 dhe 18 Mars 2018;

2. Konferenca e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Juridik: *Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integrues Euroatlantik*, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017;

3. Konferenca e Tretë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Juridik: *Drejtësia dhe sfidat e proceseve euro-atlantike*, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 18 dhe 19 Nëntor 2016;

4. Konferenca e Dytë Ndërkombëtare Shkencore: *Scientific challenges for sustainable development*, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Strugë, 17, 18 dhe 19 Prill 2015;

5. Konferenca Ndërkombëtare Shkencore: *Mendimi shkencor juridik në botën e integritimeve dhe globalizimit*, organizuar nga Shoqata e juristëve shqiptar të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 26 Nëntor 2012;

6. *Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Juridike*, organizuar nga Shoqata e juristëve shqiptar të Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 15 Dhjetor 2008;

7. Simpozium shkencor të organizuar nga Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, me temë: *Diskutime me rastin e Propozimit të të Dërguarit të posaçëm të Sekretarit Gjeneral të OKB Metju Nimic në lidhje me dallimet për emrin Republika e Maqedonisë*, Mars 2008.

III. Veprimtaria profesionale-aplikative

1. Pjesëmarrje në aktivitetet promotive të fakultetit

Kandidatja ka marrë pjesë në aktivitete promotive të Universitetit dhe Fakultetit Juridik: prezentim i Universitetit të Tetovës, Fakulteteve dhe programeve studimore të Universitetit të Tetovës në “Panairin për arsim dhe karrierë” në Shkup, Prill 2008; prezentim i Universitetit të Tetovës, Fakultetit dhe programeve studimore të Fakultetit Juridik në shkolla të mesme në Kumanovë dhe Tetovë, Prill 2008 dhe “Ditët e hapura” - promovimi i programeve studimore të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës në vitin 2009, 2010, 2011 në Tetovë.

IV. Veprimtari me interesi më të gjërë

Kandidatja ka marrë pjesë në seminarin “Përpilimi dhe menaxhimi i projekteve”, i organizuar nga Instituti për Ambient Jetësor dhe Shëndetësi pranë UEJL në Tetovë, i mbajtur në Prill 2007, në Ohër.

Nga viti 2008-2011 nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës është caktuar anëtar në komisionin për përgaditjen e dosjeve për diplomim.

Nga Marsi i vitit 2017 kandidatja është anëtare e shoqatës së Juristëve të Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 2017, me Vendim të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë nr. 09-2654/1, të datës 18.08.2017, emërohet anëtare e Grupi punues për përgaditjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noteri, Ministria e Drejtësisë, Republika e Maqedonisë.

Kandidatja ka qenë e angazhuar si Sekretar organizativ i Konferencës së IV-të Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Juridik, Universiteti i Tetovës, të mbajtur më 17 dhe 18 Nëntor 2017.

Nga 2018-vazhdon nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës është caktuar anëtar në komisionin për transfer të studentëve.

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidatja **Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi** i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe të tjera për zgjedhje në thirrje mësimore Docent.

Kandidatja Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi ka arsimimin e duhur, ka publikime të mjaftueshme, ka përvojë në fushën akademike, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe projekt hulumtues. Në bazë të kësaj, Komisioni konstaton se Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi i plotëson të gjitha kushtet për thirrje mësimore Docent të parapara në nenin 125 të Ligjit për Arsim Sipëror (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që Dr. sc. Shpresa Alimi-Memedi të zgjedhet mësimdhënës me thirrje mësimore-shkencore **Docent për lëndët: 1. E drejta civile (pjesa e përgjithshme) dhe 2. E drejta e shoqërive.**

Tetovë, 09.03.2018

Komisioni recensues

1. Prof. Dr. Agim Nuhiu

2. Prof. Dr. Bashkim Selmani

3. Doc. Afet Mamuti

SHTOJCË

PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: **Dr.sc. Shpresa Alimi-Memedi**

Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**

Programi studimor: **Studime të Drejtësisë**

VEPRIMTARIA MËSIMORE SHKENCORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Mbajtja e Ligjeratave	
1.1.	E drejta civile (3+1, Tetovë 1 semestër, Shkup 4 semestra)	$5 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 9$
1.2.	E drejta sendore (2+1, Shkup 2 semestra, Kërçovë 1 semestër)	$3 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 3.6$
1.3.	E drejta e procedurës civile (3+1, Shkup 3 semestra)	$3 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 5.4$
1.4.	E drejta e shoqërive (2+1, Shkup 4 semestra)	$4 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 4.8$
1.5.	E drejta e autorit (2+1, Tetovë 1 semestër)	$1 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 1.2$
1.6.	E drejta familjare (2+1, Kërçovë 1 semestër)	$1 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 1.2$
1.7.	Terminologjia juridike (2+1, Shkup 1 semestër)	$1 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 1.2$
2.	Mbajtja e Ushtrimeve	
2.1.	E drejta civile (3+1, Tetovë 3 semestra, Shkup 4 semestra)	$7 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 6.3$
2.2.	E drejta sendore (2+1, Tetovë 3 semestra, Shkup 4 semestra, Kërçovë 1 semestër)	$7 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 6.3$
2.3.	E drejta e procedurës civile (3+1, Shkup 4 semestra)	$4 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 3.6$
2.4.	E drejta romake (2+1, Tetovë 2 semestra, Shkup 3 semestra)	$5 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 4.5$
2.5.	E drejta e shoqërive (2+1, Tetovë 2 semestra, Shkup 4 semestra)	$5 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 4.5$
2.6.	E drejta e autorit (2+1, Tetovë, 1 semestër)	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
2.7.	E drejta familjare (2+1, Kërçovë, 1 semestër)	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
2.8.	Terminologjia juridike (2+1, Shkup, 1 semestër)	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
2.9.	E drejta detyrimore (2+1, Tetovë 1 semestër)	$1 \times 15 \times 2 \times 0.03 = 0.9$
2.10.	E drejta afariste (2+1, Fakulteti i Administratës së Biznesit, Kërçovë, 1 semestër)	$1 \times 15 \times 1 \times 0.03 = 0.45$
3	Konsultime me studentë	
3.1.	E drejta civile (3+1, Tetovë 1 semestër, Shkup 4 semestra)	$120 \times 5 \times 0.002 = 1.2$
3.2.	E drejta sendore (2+1, Shkup 2 semestra, Kërçovë 1 semestër)	$120 \times 3 \times 0.002 = 0.72$
3.3.	E drejta e procedurës civile (3+1, Shkup 3 semestra)	$80 \times 3 \times 0.002 = 0.48$
3.4.	E drejta romake (2+1, Tetovë 2 semestra, Shkup 2 semestra)	$120 \times 4 \times 0.002 = 0.96$
3.5.	E drejta e shoqërive (2+1, Shkup 4 semestra)	$100 \times 4 \times 0.002 = 0.8$

3.6.	E drejta e autorit (2+1, Tetovë 1 semestër)	30x1x0.002=0.06
3.7.	E drejta familjare (2+1, Kërçovë 1 semestër)	60x1x0.002=0.12
3.8.	Terminologjia juridike (2+1, Shkup 1 semestër)	120x1x0.002=0.24
3.9.	E drejta detyrimore (2+1, Tetovë 1 semestër)	60x1x0.002=0.12
3.10.	E drejta afariste (2+1, Fakulteti i Administratës së Biznesit, Kërçovë 1 semestër)	60 x1x0.002=0.12
4	Përgaditja e lëndës së re (ligjerata/ushtrime)	
4.1.	E drejta sendore (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.2.	E drejta romake (ushtrime)	0.5
4.3.	E drejta e shoqërive (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.4.	E drejta e procedurës civile (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.5.	E drejta e autorit (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.6.	E drejta afariste, Fakulteti i Administratës së Biznesit (ushtrime)	0.5
4.7.	Terminologjia juridike (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.8.	E drejta familjare (ligjerata dhe ushtrime)	1.5
4.9.	E drejta finansiare (ushtrime)	0.5
4.10	E drejta detyrimore (ushtrime)	0.5
5	Mentor në mësim praktik	
5.1	Mentorim të studentëve të vitit të tretë të Fakultetit Juridik (studimet e disperzuara në Shkup) në Gjykatën Themelore Shkupi I-Shkup dhe Komunën e Çairit, 2017 dhe 2018	2x1=2
6.	Skriptë interne nga ligjeratat	
6.1.	E drejta e autorit (Ligji për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta i Republikës së Maqedonisë), Material plotësues për përgaditjen e provimit nga lënda “E drejta e autorit”, Tetovë, 2017	4
	GJITHSEJ:	76.12

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1.	Teza të mbrojtura	
1.1.	“Pavlefshmëria e kontratave me vështirim të posaçëm në Ligjin mbi marrëdhëniet detyrimore të Republikës së Maqedonisë”, punim i magistraturës, 2010	
1.2.	“Начелото на автономија на волјата на договорните страни во договорното право на Република Македонија и во европското договорно право”, disertacion i doktoraturës, 2017	
2	Pjesëmarrje në projekte	
2.1.	Projekt hulumtues-shkencor i miratuar dhe finansuar nga Ministria e kulturës së Republikës së Maqedonisë, në kuadër të Programin vjetor të Ministrisë së kulturës për projekte me interes nacional në kulturë për vitin 2018, nga cili në botim është monografia me titull: “Начелото на	3

	слобода на договарање во француското и германското право”, Shkup, 2018	
3.	Monografi	
3.1.	“Начелото на слобода на договарање во француското и германското право”, Shkup, 2018, Recensentë: Prof. Dr. Osman Kadriu dhe Doc. Dr. Afet Mamuti	8
4	Artikuj me rezultate shkencore origjinale, të publikuara në revistë referente shkencore/profesionale me bord redaktues ndërkombëtar	
4.1.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Формализмот во македонското договорно право</i> , Knowledge International Journal, ISSN 1857-923X, Global Impact & Quality Factor 1.322 për vitin 2016, Vol. 22/2018, Shkup, 2018, Botim nga Sixteenth International Scientific Conference, Topic: Knowledge without borders, organizuar nga Institute of Knowledge Management, Vrnjačka Banja, Republika e Sërbisë, 15, 16, 17 dhe 18 Mars 2018	6
4.2.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Автономија на волјата на договорните страни и нејзините опити граници во Законот за облигационите односи на Република Македонија</i> , Centrum - International Scientific Journal, ISSN: 1857-8640 (Print), ISSN: 1857-9396 (Online), UDC 3(497.7:4-672 EU), Global Impact & Quality Factor 0.784 për vitin 2016, No. 8/2017, Shkup, 2017, qasje në: http://centrum.mk/wp-content/uploads/2017/12/PJESA-21.pdf	6
4.3.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Freedom of contract and consumer protection in the Directive 93/13/ECC on unfair terms in consumer contracts and the Directive 2011/83/EU on consumer rights</i> , në botim në Iusticia (Revistë Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, Vol. 6, Nr. 8, Tetovë, 2018, botim nga Konferenca e katërt Ndërkombëtare Shkencore e Fakultetit Juridik: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017	6
4.4.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Pazotësia e veprimit si shkak për nulshmërinë e kontratave në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë</i> , The Heritage, ISSN 1857-7482, No. 2/2015, Strugë, 2015, qasje në: http://www.eust.edu.mk/Heritage/files/SCfSD15.pdf , botim nga Konferenca e dytë ndërkombëtare shkencore: Scientific Challenges for Sustainable Development, Organizera: International University of Struga (IUS), Book of Proceedings, Struga, 17, 18, 19, April 2015	6
4.5.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Autonomia e vullnetit të palëve nga feudalizmi në bashkëkohësi</i> , Vizione (Revistë ndërkombëtare për shkencat shoqërore), ISSN 1409-8962-printed form, ISSN 1857-9221-electronic form, Nr. 23/2015, Shkup, 2015, qasje në: http://visionsmagazine.org/visions-magazine-issue-no-23/	6
4.6.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Origjina e autonomisë së vullnetit të palëve kontraktuese dhe zhvillimi i saj në të drejtën romake</i> , Iusticia (Revistë Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, Nr. 1/2014, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2014	6
4.7.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Autonomia e vullnetit dhe kufijtë e saj në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë</i> , Iusticia (Revistë	6

	Ndërkombëtare Shkencore), ISSN 1857-8454, Nr. 1/2013, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 2013	
4.8.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Nulshmëria e kontratave në Ligjin mbi marrëdhëniet detyrimore të Republikës së Maqedonisë</i> , Ulpianus-Revistë shkencore dhe profesionale për drejtësi e shoqatës së juristëve shqiptarë të Republikës së Maqedonisë, ISSN 1857-8144, Viti 2, Nr. 2 (2012), Tetovë, 2012	4
4.9.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Çështja e ekzistimit të punëve juridike joekzistuese</i> , Përmbledhje e punimeve shkencore nga Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Juridike, Shoqata e juristëve shqiptarë të Maqedonisë, ISBN 9989-2725-7-8, Tetovë, 15 Dhjetor 2008	4
5	Pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare shkencore dhe simpoziume nacionale	
5.1.	Pjesëmarrëse në Sixteenth International Scientific Conference Topic: Knowledge without borders, organizuar nga Institute of Knowledge Management, Vrnjacka Banja, Republika e Serbisë, 15, 16, 17 dhe 18 Mars 2018	2
5.2.	Pjesëmarrëse në Konferencën e Katërt Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Juridik: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017	2
5.3.	Pjesëmarrëse në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare Shkencore të Fakultetit Juridik: Drejtësia dhe sfidat e proceseve euro-atlantike, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 18 dhe 19 Nëntor 2016	2
5.4.	Pjesëmarrëse në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare Shkencore: Scientific challenges for sustainable development”, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Strugë, 17, 18 dhe 19 Prill 2015	2
5.5.	Pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore: Mendimi shkencor juridik në botën e integritimeve dhe globalizimit, organizuar nga Shoqata e juristëve shqiptar të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 26 Nëntor 2012	2
5.6.	Pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore Juridike, organizuar nga Shoqata e juristëve shqiptar të Republikës së Maqedonisë, Tetovë, 15 Dhjetor 2008	2
5.7.	Pjesëmarrëse në simpoziumin shkencorë të organizuar nga Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë” pranë Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” në Shkup, me temë: “Diskutime me rastin e Propozimit të të Dërguarit të posaçëm të Sekretarit Gjeneral të OKB Metju Nimic në lidhje me dallimet për emrin Republika e Maqedonisë”, Mars 2008	2
6	Abstrakte të botuara në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare	
6.1.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Freedom of contract and consumer protection in the Directive 93/13/ECC on unfair terms in consumer contracts and the Directive 2011/83/EU on consumer rights</i> , Libri i abstrakteve nga Konferenca Ndërkombëtare-Shkencore Juridike: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, ISBN 978-608-217-064-0, 17-18 Nëntor,	1

	2017	
6.2.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Dëmtimi tejmasë në të drejtën kontraktore të Republikës së Maqedonisë</i> , Libri i abstrakteve nga Konferenca Ndërkombëtare Shkencore Juridike: Drejtësia dhe sfidat e proceseve euro-atlantike, ISBN 978-608-217-048-0, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 18-19 Nëntor, 2016	1
6.3.	Shpresa Alimi-Memedi, <i>Capacity to act of legal persons with special emphasis on harmonization of Macedonian Contract Law with European Union Law</i> , Libri i abstrakteve nga Konferenca shkencore ndërkombëtare: Legal Scientific Thought in the Era of Integration and Globalization, ISSN: 1857-8144, Shoqata e juristëve shqiptar të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 25 Nëntor 2012	1
	GJITHSEJ	78

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1	Pjesëmarrje në aktivitete promotive të fakultetit	
1.1	Prezentim i Universitetit të Tetovës, Fakulteteve dhe programeve studimore të Universitetit të Tetovës në “Panairin për arsim dhe karrierë në Shkup”, Prill 2008	1
1.2.	Prezentim i Universitetit të Tetovës, Fakultetit dhe programeve studimore të Fakultetit Juridik në shkolla të mesme në Kumanovë dhe Tetovë, Prill 2008	1
1.3.	“Ditët e hapura” - Promovimi i programeve studimore të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës në vitin 2009, 2010, 2011, Tetovë	3x1=3
	GJITHSEJ	5

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1.	Anëtare e Grupi punues për përgaditjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për noteri, Ministria e Drejtësisë, Republika e Maqedonisë, Vendimi i Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë nr. 09-2654/1 i datës 18.08.2017	2
2.	Sekretar organizativ i Konferencës së IV-të Ndërkombëtare Shkencore: Sfidat e sigurisë dhe standardet universal në procesin integruar Euroatlantik, Universiteti i Tetovës, Tetovë, 17 dhe 18 Nëntor 2017	1
3.	Pjesëmarrëse në seminarin “Përpilimi dhe menaxhimi i projekteve”, organizuar nga Instituti për Ambient Jetësor dhe Shëndetësi, pranë UEJL në Tetovë, i mbajtur më Prill 2007, Ohër	1
4.	Anëtare e shoqatës së Juristëve të Republikës së Maqedonisë, nga Marsi	1

	2017	
5.	Anëtar në komisionin për përgaditjen e dosjeve për diplomim, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 2008-2011	1
6.	Anëtar i komisionit për transfere, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 2018-vazhdon	1
	GJITHSEJ:	7

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	76.12
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	78
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative	5
4.	Veprimtaria me interes më të gjërë	7
	Gjithsej:	166.12

Komisioni Recensues:

1. Prof. Dr. Agim Nuhiu

2. Prof. Dr. Bashkim Selmani

3. Doc. Afet Mamuti

Drejtuar:
**Këshillit të Rektoratit të
Universitetit të Tetovës**
Tetovë

R E F E R A T

për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët *E drejta e procedurës penale dhe Bazat e sistemit gjyqësor* në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, “www.unite.edu.mk” dhe në gazetën ditore “Koha” me datë 31.01.2018, për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar** për lëndët: **E drejta e procedurës penale dhe Bazat e Sistemit Gjyqësor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës**, me Propozim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik nr. 13-178/3 të datës 20.02.2018 dhe me Vendim të Këshillit të Rektoratit nr.02-1136/1 të datës 06.03.2018 formohet **Komisioni recenzues** në përbërje:

- 1. Prof.dr. NASER ADEMI - Kryetar**
- 2. Prof.dr. QEBIR AVZIU – anëtar**
- 3. Prof.dr. AFRIM OSMANI anëtar**

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenet 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsim të Lartë (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve dhe asistent-doktorantëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N Z I O N

Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës me datë 30.01.2018 në web faqen www.unite.edu.mk dhe në gazetën ditore “Koha”, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: **1. E drejta e procedurës penale dhe 2. Bazat e Sistemit Gjyqësor** në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, **u paraqit kandidati:**

1. Doc.Dr. Arta Bilalli Zendeli

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Doc.dr. Arta Bilalli Zendeli ka lindur më 11.04.1981 në Prishtinë- Republika e Kosovës. Shkollimin fillor e ka filluar në Prishtinë kurse e ka mbaruar në shkollën fillore “Përparimi” të fshatit Çegran- Gostivar. Shkollimin e mesëm e ka kryer në Gjimnazin “Pançe Poposki”, drejtimi Matematik-natyror në Gostivar, ku edhe është zgjedhur nxënësja më e mire e gjeneratës 1997/98. Ka studiuar dhe diplomuar me note mesatare 8.20 në Fakultetin Juridik “Justinijani i Parë” të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup, ku dhe fiton titullin Jurist i diplomuar.

Në vitin akademik 2003/04 ka regjistruar studimet posdiplomike të magjistraturës në Fakultetin Juridik “Justinijani i Parë” të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup. Studimet pasdiplomike të magjistraturës i mbaron me notë mesatare të lëndëve 9.66(6), kurse me datë 17.03.2008 mbron tezën e magjistraturës: “Dëshmitari i mbrojtur në procedurën penale”, në mentorimin e Prof. Dr. Gordana Biuzharovska Lazhetiq, e cila vlerësohet me sukses të shkëlqyeshëm nga Juria Profesionale dhe e njëjta fiton titullin Magjistër i Shkencave Juridike nga lëmia e së drejtës penale

Kandidatja Arta Bilalli Zendeli në vitin 2008 regjistron Studimet e Doktoratës në Fakultetin Juridik “Justinijani i Parë” të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup. Në mbledhjen e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë, kandidates i miratohet teza e doktoratës “Barra e të provuarit në procedurën penale” me udhëheqës shkencor Prof. Dr. Gordana Buzharovska Lazhetiq. Disertacionin e doktoraturës kandidati e mbron më 09.11.2011 para Jurisë për mbrojtjen e doktoraturës në përbërje të 1. Akademik Vlado Kambovski- Kryetar, 2. Prof. dr. Gordana Buzharovska Lazhetiq- Mentor, 3. Prof. dr. Nikola Tupançeski- Anëtar, 4. Prof. dr. Gordan Kallajxhiev- Anëtar dhe 5. Doc. Dr. Lazar Nanev- Anëtar dhe kandidatja fiton titullin shkencor **Doktor i Shkencave Juridike**.

Kandidatja Dr. Arta Bilalli Zendeli në konkurs i dorëzoi këto dokumente:

1. Diplomën e Doktoratës (kopje të noterizuar);
2. Vendimin për zgjedhje rizgjedhje në Thirrjen mësimore-shkencore Docent (kopje të noterizuar);
3. Listën e punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara në revista shkencore dhe konferenca shkencore, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
4. Vërtetim për njohje të gjuhës së huaj;
5. Biografi të shkurtër (CV) nga e cila mund të konstatohen aktivitetet permanente shkencore dhe profesionale dhe konferenca të shumta të nivelit shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar;
6. Çertifikatë nga libri amzë i të lindurve;
7. Çertifikatë shtetësie;
8. Kopje të çertifikatave dhe mirënjohjeve tjera.

Përvoja universitare

Përvoja universitare e kandidates Doc.dr. Arta Bilalli Zendeli tregon një kontinuitet nga viti 2004. Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, nga Komisioni amë për themelimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, zgjedhet **Asistent i ri**, në marrëdhënie pune të rregullt në Fakultetin Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga data 01.11.2004, Vendimi i evidentuar me numër 23-2805/703, të datës 24.08.2004 në lëndën E drejta administrative. Më 12.08.2009, emërohet U. D. Koordinator për ECTS në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës (Vendimi nr. 02-3549/1 nga data 14.08.2009), detyrë të cilën e realizoi deri në shkurt të vitit 2011.

Më 22.03.2010 zgjedhet bashkëpunëtor në thirrjen **asistent** për lëndët E drejta e procedurës penale dhe Kriminalistika në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës (Vendimi numër 02-1759/1 të datës 19.04.2010).

Pas hapjes së studimeve të disperzuara në Shkup dhe Kërçovë nga USHT-ja, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, kandidatja ka qenë e angazhuar në Studimet e Disperzuara në Kërçovë në lëndët mësimore: E drejta e procedurës penale, Kriminalistika dhe Penologji me Kriminologji.

Në mbledhjen e mbajtur më 21.02.2013, nga Këshilli i Rektoratit zgjedhet në thirrjen mësimore-shkencor **Docent** për lëndën E drejta e procedurës penale (Vendimi nr. 04-1915/1 të datës 04.04.2013, pozitë të cilën e ushtron në kontinuitet edhe aktualisht. Më 11.03.2015, nga ana e Dekanit të Fakultetit Juridik, emërohet Koordinator për Ciklin e Dytë të Studimeve Pasuniversitare (Vendimi nr. 13-311/1 nga 11.03.2015)- pozitë të cilën e ushtron edhe aktualisht.

Nga viti 2013 gjithashtu është e angazhuar edhe në studimet Master në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në lëndët: 1. Penologji, 2. E drejta e procedurës penale, 3. E drejta penale- program i zbatuar si dhe është anëtare e rregullt e Këshillit të Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës.

Aktivitete profesionale dhe shkencore:

- 2004-2005, ka punuar në Zyrën Nacionale Tempus pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës- Shkup;
- Më 24.08.2004 – me Vendim të Komisionit amë për themelimin të Universitetit Shtetëror të Tetovës, zgjedhet në thirrjen mësimore të bashkëpunëtorit **asistent i ri** për lëndën *E drejta administrative*;
- Nga 11.07-23.07.2005, ka qenë ligjëruese në International Summer University Macedonia 2005, në Fakultetin Juridik të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup;
- Nga 09.07-22.07.2007, ka qenë ligjëruese në International Summer University Macedonia 2007, në Fakultetin Juridik të Universitetit “Shën Klimenti i Ohrit”- Manastir;
- Më 12.08.2009, emërohet Koordinator për ECTS në Fakultetin Juridik-UT (Vendimi nr. 02-3549/1 nga data 14.08.2009)

- Në nëntor, 2009 ka qenë Erasmus Profesor në Universitetin e Mariborit- Slloveni;
- Në vitin 2010, në konkursin për zgjedhje – rizgjedhje të USHT-së, kandidati avansohet në thirrjen mësimore të *asistentit* për lëndët: E Drejta e procedurës penale dhe Kriminalistika;
- Më 2013, ligjëron në Studimet Master- Fakulteti Juridik “Justinijani i Parë”- Universiteti “Shën Kirili dhe Metodi”- Shkup;
- Në vitin 2013, me Vendim të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, caktohet anëtare e Grupi punues për harmonizimin e legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë me legjislacionin e Bashkimit Europian;
- Nga 01.05.2013-01.07.2014, zgjidhet Këshilltare e jashtme e Ministrit të Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë;
- Në vitin 2014, me Vendim të Ministrit të Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, caktohet anëtare e Grupi punues për reformimin e legjislacionit penal dhe përgatitjen e ligjeve përkatëse në Republikën e Maqedonisë;
- Në vitin 2015, nga ana e OSBE-së, Misioni në Shkup, caktohet si Ekspert Nacional për mentorimin dhe përgatitjen e studentëve për projektin “Ditët e Gjykimit të Simuluar”, me ç’rast më 15.12.2017, fiton *Vendin e parë* me studentët e Fakultetit Juridik, në nivel shtetëror;
- 26.08.2015-17.11.2017 nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë zgjidhet anëtare e Komisionit për unifikimin e politikës penale pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- Në korrik, 2017, me Aktvendim të Ministrit të Drejtësisë (Nr. 23-2279/1 nga 17.07.2017), caktohet anëtare e Grupit punues për revidimin e Strategjisë për reforma në sistemin e drejtësisë dhe hartimin e Planit Akcional;
- Në tetor, 2017, nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës- Shkup, nominohet për Programin Ndërkombëtarë IVLP- Sundimi i së drejtës në SHBA dhe nga nëntori deri në dhjetor e realizon të njëjtin në SHBA;
- Në nëntor, 2017, me Aktvendim të Ministrit të Drejtësisë (Nr. 08-3546/1 nga 01.11.2017), caktohet anëtare e Grupit punues për hartimin e ligjeve nga lëmia penale-juridike në pajtim me Strategjinë për reforma në sistemin e drejtësisë dhe implementimin e mehanizmit për kontrollë të jashtëm;
- Udhëheqëse shkencore e më shumë studentëve në master dhe anëtar dhe Kryetare e disa Komisioneve për mbrojtje të Masterit.
- Anëtare e Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "JUSTICIA" të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës;
- Anëtar i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore të Institutit për Hulumtime Shkencore dhe Zhvillim, Ulqin, Mali i Zi

- Anëtare e këshillit organizativ në Konferencën Ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE” të organizuar nga Fakulteti Juridik – Univeristeti i Tetovës, me datë 18-19 nëntor 2016
- Anëtare e komitetit organizativ të “4th International Scientific Conference - Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” she Sekretare e Konferencës, 17-18 November 2017 University of Tetova, Tetova, Macedonia;
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare 1st International Conference on the Occasion of Human Rights Day, 10 December, organizuar nga Qendra për Mirëkuptim dhe Bashkëpunim Institucional, 10.12.2012, Shkup, me temë “Rrjedha e procedurës penale dhe konskeuencat e saj ndaj të pandehurit”;
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “The integration of the southeastern Europe in the European Union – Challenges” ,Tetovë, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT-së 29-30 qershor 2013.
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare „SHTETI JURIDIK DHE DEMOKRACIA” Tetovë 12.03.2014, me temën “*Standardi i të provuarit në procedurën penale*”
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën e I-rë Shkencore regjionale “E drejta dhe kultura politike si factor ndikues në ndërtimin e shtetit modern”, organizuar nga Instituti për Studime ligjore dhe demokratike, Gjilan, 20.09.2014, me temë: “Vështtrim komparativ i rolit të Gjykatës në propozimin e provave në procedure penale”
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën e II-të Shkencore regjionale “Sundimi i ligjit dhe siguria publike-faktor ndikues për bashëpunim ekonomik dhe rajonal”, organizuar nga Instituti për Studime ligjore dhe demokratike, Gjilan, 07.03.2015
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare 2nd International Conference on Bussines, Law, Adminitration and Social Sciences- ICBLAS 2015, në Universitetin e Biznesit në Tiranë, më 04.04.2015;
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare Within CEPOS 5th Edition on the International Conference After Communism. East and West under Scrutiny, Craiova, House of the University, 24-25 April, 2015 me temën: “Privilege against self-incrimination- guarantee for fair trial in modern criminal procedures;
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare me temën “To no one will we sell, to no one deny or delay right or justice” – the legacy of Magna Carta 1215 for the Western Ballkans, organizuar nga UEJL- Tetovë, më 17.06.2015, me temën “Interrogation and the Right to remain silent”
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “Universality, Globalization and the Rule of Law” datë 13-14 nëntor 2015, me temën “Ndikimi i rrethanave lehtësuese dhe rënduese në matjen e dënimit”, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT.

- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE, 18-19 nëntor, 2016, me punimin “Mbrojtja e dëshmitarëve në procedurën penale”
- Kandidatja Arta Bilalli Zendeli, ka marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare 4th International Scientific Conference “Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” 17-18 nëntor, 2017, Universiteti i Tetovës duke prezantuar punimin “Sistemi i sanksioneve penale në Republikën e Maqedonisë” (
- Ka marrë pjesë në emisione debative televizive si: Rruga drejt..., 360 Shkallë, Отворено, Анализа, итн.

Punime të botuara në Revista Ndërkombëtare Shkencore:

Vizione, 25/2016, Harmonization of the penal policy- A challenge to the Criminal Theory and Practice, Arta Bilalli- Zendeli and Gjorgji Slamkov, Shkup, 2016

Vizione 25/2016, Prevention of Corruption – improving the efficiency in the monitoring of the assets, Gjorgji Slamkov and Arta Bilalli Zendeli, Shkup, 2016

SEEU Review, Volume 11, Issue 1, December, 2015, Interrogations and the Right to Remain Silent, Tetovë, 2015

Revista di Stiinta Politica, University of Cariova, Privilege against self-incrimination- a guarantee for fair trial in modern criminal procedure, 47/2015, Romania

Vizione, 23/1 , Shkup, 2015, E drejta e mbrojtjes ne procedure penale (the Right of Defense in Criminal proceedings)

Vizione, 22/1, Shkup, 2014, Vështrim komparativ i rolit te gjykates ne propozimin e provave (Comparative view on the role of the court in proposing evidences)

Justicia, Revistë Ndërkombëtare - Shkencore Juridike - International Journal of Legal Sciences, Faculty of Law, State University of Tetova, No.3, Tetova, 2014 Standardi i te provuarit ne procedure penale (The standard of proof in Criminal procedure), Rrjedha e procedures penale dhe konsekuencat e saj ndaj te pandehurit (The progress of criminal procedure and its consequences toward the defendant), Centrum, Center for Understanding and Institutional Cooperation, Shkup, I/ 2013

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të analizës të aktiviteteve të lartëpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidatja Arta Bilalli Zendeli i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Inordinar**, duke u mbështetur edhe në përvojën e vazhdueshme profesionale, akademike dhe pedagogjike të kandidatit.

8. Blerta Idrizi, *The right to private life in RM, and in correlation with European Convention for the Protection of Human Rights and Fundamental Freedoms* (2015);
9. Dokleata Qamili, *Ethnic discrimination in the Republic of Macedonia in the light of International convention on the elimination of all forms of racial discrimination and the Ohrid framework agreement* (2015);
10. Hadije Abdullai, *Standardet e të drejtave të njeriut në korporatat multinacionale* (2015);
11. Lirim Jashari, *Standardet e Unionit Europian për parandalimin e Terorizmit në korelacion me legjislacionin e Republikës së Maqedonisë* (2015);
12. Shqipe Bytyqi, *Mbrojtja nga dhuna në familje në Republikën e Kosovës në korelacion me standardet ndërkombëtare* (2015);
13. Vjollca Adili, *The right to life and abortion: international and national standards* (2016);
14. Lira Bojko, *Implementimi i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave në Republikën e Maqedonisë* (2016);
15. Lumrim Murtezaj, *Njohja e shteteve në të drejtën ndërkombëtare me fokus të veçantë ndaj Kosovës* (2016);
16. Valbon Berisha, *Roli i misioneve paqeruajtëse në suaza të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare* (2016);
17. Majlinda Shabani, *E drejta e përdorimit të gjuhës nga ana e bashkësive jo shumicë para dhe pas implementimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit* (2017);
18. Sejdulla Alimi, *Liria e besimit fetarë në Republikën e Maqedonisë* (2017);
19. Kaltrina Azizi, *Zbatimi i përfaqësimit të drejtë dhe adekuat në Republikën e Maqedonisë* (2017).

3.2. Të pambrojtura

1. Kujtim Neziri, *Ndihma juridike në të drejtën ndërkombëtare private*;
2. Xhevit Dauti, *Kompetenca ndërkombëtare dhe e drejta e zbatueshme të marrëdhëniet familjare me element ndërkombëtar*;
3. Herolind Limani, *E drejta e përdorimit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë*;
4. Enisa Ibraimi, *Institucionet për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri*;
5. Arta Skenderi, *Diskriminimi gjinor në marrëdhëniet e punës në Republikën e Maqedonisë*;
6. Alban Abdul, *Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve të huaja gjyqësore në Gjykatën e Tetovës për periudhën 2013-2017*.

7. Alma Ziba, Zhvillimi i të drejtave të njeriut në suaza të OKB-së;

3.3. Anëtarë komisioni për vlerësim dhe mbrojtje:

Doc Dr Bekim Kadriu ka qenë anëtarë i mbrojtjes së temave te kandidatët: Abdulla Sejдини, Alban Ramadani, Drion Hismani, Ekmonda Dauti, Jakup Huseini, Luiza Kaba, Mirisha Lufi, Muhamet Ameti, Veli Xheladini, Xhejlane Hismani, Shaban Jusufi, Diana Toçka, Gazmend Misini, Hysni Shala, Jetmire Tairi, Mendurim Presheva, Rexhep Ismaili, Sherije Dauti, Nijazi Hamidi, Mentor Sylmeta, Afrim Etemi, Majlind Muji, Bledar Buxhaku, Ylber Aliji, Florenc Hoxha.

IV. VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJERË

1. Anëtar i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, prej 11 janar 2016 (mandat 5 vite);
2. Çmimin shtetëror “13 nëntori” për vitin 2015 për shkencë dhe publicistikë.

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidati **Doc. Dr. Bekim Kadriu** i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe të tjera për zgjedhje në thirrje mësimore PROFESOR INORDINAR.

Kandidati Doc Dr. Bekim Kadriu ka arsimimin e duhur, ka publikime të mjaftueshme, ka përvojë në fushën akademike, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare dhe projekte hulumtuese. Në bazë të kësaj, Komisioni konstaton se Doc. Dr. Bekim Kadriu i plotëson të gjitha kushtet për thirrje mësimore PROFESOR INORDINAR të parapara në nenin 125 të Ligjit për Arsim të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr 35/2008), Statutin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doc. Dr. Bekim Kadriu** të zgjidhet mësimdhënës me thirrje mësimore-shkencore **PROFESOR INORDINAR** për lëndët **1. E drejta ndërkombëtare private dhe 2. Liritë dhe të drejtat e njeriut.**

Tetovë, 01.03.2018

Komisioni recensues

1. Prof. Dr. Ljubomir D. Frçkoski, kryetar

2. Prof. Dr. Blerim Reka, anëtar

3. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar

SH T O J C Ë
**PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJE-RIZGJEDHJE NË THIRRJEN MËSIMORE-
 SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

KANDIDATI: BEKIM KADRIU

INSTITUCIONI: FAKULTETI JURIDIK, UNIVERSITETI I TETOVËS

LËNDËT: **1. E DREJTA NDËRKOMBËTARE PRIVATE**
 2. LIRITË DHE TË DREJTAT E NJERIUT

TITULLI: **PROFESOR INORDINAR (I ASOCUAR)**

VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE

Nr. rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	
1.1.	E drejta ndërkombëtare private-Tetovë(3+2)	3x15x5x0.04=9
1.2.	E drejta ndërkombëtare private-Shkup(3+2)	3x15x5x0.04=9
1.3.	E drejta ndërkombëtare private-Kërçovë(3+2)	3x15x5x0.04=9
1.4.	Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut-Tetovë (2+1)	2x15x5x0.04=6
1.5.	Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut-Shkup(2+1)	2x15x4x0.04=4.8
1.6.	Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut-Kërçovë (2+1)	2x15x4x0.04=4.8
1.7.	Të drejtat e njeriut (2+0)	2x15x1x0.04=1.2
1.8.	Të drejtat e njeriut (2+0)	2x15x1x0.04=1.2
2.	Mbajtja e ushtrimeve (lëndët në ciklin e parë të studimeve)	
2.1.	Ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut(2+1)	3x15x1x0.03=1.35
3.	Mbajtja e ligjëratave (lëndët në ciklin e dytë të studimeve)	
3.1.	E drejta ndërkombëtare private	2x15x6x0.05=9
3.2.	Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut	2x15x4x0.05=6
3.3.	Konflikti i ligjeve	2x15x1x0.05=1.5
3.4.	Ndalimi i diskriminimit në të drejtën ndërkombëtare	2x15x1x0.05=1.5
3.5.	E drejta ndërkombëtare dhe institucionet ndërkombëtare (anglisht)	2x15x1x0.05=1.5
3.6.	Hyrje në të drejtat e njeriut (anglisht)	2x15x1x0.05=1.5
3.7.	Arbitrazhi ndërkombëtar	2x15x1x0.05=1.5
3.8.	Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut (anglisht)	2x15x2x0.05=3
4.	Mentor i kandidatëve dhe anëtarë komisioni për vlerësim dhe mbrojtje të temave të magistraturës	
4.1.	Të mbrojtura	19x3=57
4.2.	Të pambrojtura	7x2=14
4.3.	Anëtar komisioni për vlerësim dhe mbrojtje të temave	25x1=25
5.	Libra universitar	
5.1.	E drejta ndërkombëtare private, libër universitar, UT, 2015, Tetovë.	10

	GJITHSEJ	177.85
--	-----------------	---------------

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	PJESËMARRJA NË PROJEKTE	
1.1.	Pjesëmarrje si hulumtues në projekt nacional <i>Analysis of discriminatory practices in the area of employment and labour relations</i> (ca-author with Zaneta Stojkoska, Lence Kocevaska and Elena Kocoska), OSBE Mission in SKopje, 2013, (anglisht);	3
1.2.	Pjesëmarrje si hulumtues në projekt ndërkombëtar: <i>Assessing the legislation tackling issues of gender-based violence and human trafficking and smuggling in Albania, Kosovo, Serbia, Macedonia and Bosnia and Herzegovina</i> , European Agency for Development, 2016 (anglisht);	5
1.3.	Pjesëmarrje si hulumtues në projekt nacional <i>Analizë e praktikave diskriminuese në arsim</i> , OSBE Misioni në Shkup dhe Ministria për punë dhe politikë sociale, Qershor-Gusht 2014;	3
1.4.	Pjesëmarrje si hulumtues në projekt nacional <i>Analizë e politikave të distribuimit të resurseve lokale ndërmjet bashkësive etnike në Pollog dhe Pellagoni</i> , Mars-Dhjetor 2015, Asociacioni për iniciativa demokratike, Gostivar.	3
2.	PJESËMARRJA NË KONFERENCA SHKENCORE DHE SIMPOZIUME NACIONALE DHE NDËRKOMBËTARE	
2.1.	<i>The right to use Albanian language as an official language in Macedonia: the new draft law, its content, advancement and comparison</i> , paper in the international conference UBT 6 th Annual International Conference, 27-29 October 2017, Durres, Albania (in English);	3.0
2.2.	<i>Puna e Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi</i>	2.0

	<i>në fushën e teksteve shkollore me përmbajtje diskriminuese, konferenca Drejt arsimimit pa diskriminim: Angazhim për tejkalimin e diskriminimit në tekstet shkollore të arsimit të lartë, Fakultet Juridik ne Shkup, 07 dhjetor 2017, Shkup (maqedonisht);</i>	
2.3.	<i>Si të përmirësohet implementimi i Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, konferencë Përmirësimi i mbrojtjes nga diskriminimi, me fokus të veçantë në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, 22.03.2017, Holiday Inn, Shkup (maqedonisht);</i>	2.0
2.4.	<i>Promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet arsimit: Pse është e rëndësishme të kemi mësim për të drejtat seksuale dhe reproduktive? Prezantim në konferencë “Sfidat dhe mundësitë për arsimim më të mirë për të drejtat seksuale dhe reproduktive, Fakulteti filozofik Shkup, 28 Tetor, 2016 (maqedonisht);</i>	2.0
2.5.	<i>Autonomia e vullnetit të palëve në të drejtën ndërkombëtare private moderne, konferenca e Fakultetit Juridik pranë UT, Drejtësia dhe sfidat e proceseve euroatlantike, 18-19 nëntor 2016, Tetovë (abstrakt);</i>	1.0
2.6.	<i>Ligjeratë E drejta e votës, gratë dhe barazia gjinore, prezantim në projekt rritja e vetëdijes te gratë lidhur me të drejtën e votës, Fondacioni shoqëri e hapur, Kërçovë, 22.10.2016 (maqedonisht);</i>	2.0
2.7.	<i>Establishment of special judicial mechanism: The case of the Republic of Macedonia, State University of Tirana, Transition of the law and law in transition: Social, Political and Normative processes in a comparative perspective, Tirana, 28-29 April, 2016 (anglisht);</i>	3.0
2.8	<i>Age discrimination in Macedonia: Legislation and practice vis a vis European Union Law, 2014 International Elder Law and Policy Conference, John Marshal law School, Chicago, USA, 10-11 July 2014 (anglisht);</i>	3.0
2.9.	<i>Protection of Minorities after the First World War: Specifics, Consequences and reflections today, in the conference The Balkans 100 years after the start of the First World War, South East European University, 28.06.2014 (abstrakt);</i>	1.0

2.10.	<i>The principle of equality and state support for religious communities in Macedonia: Between secularism and religion</i> , International conference the impact of religion, May 20-22 2013, <u>Uppsala</u> , Finland (anglisht);	3.0
3	ARTIKUJ ME REZULTATE ORIGJINALE SHKENCORE/PROFESIONALE, TË PUBLIKUARA NË KONFERENCA NDËRKOMBËTARE ME PROCEEDINGS ME BORD REDAKTUES NDËRKOMBËTAR, NË REVISTA NDËRKOMBËTARE SI DHE NË REVISTA ME IMPAKT FAKTOR	
3.1.	<i>Between secularism and state support of religious communities: An (In)equality dilemma</i> , Iliria International Review, Vol. 7, No. 2, 2017;	6.0
3.2.	<i>The right to use Albanian language as an official language in Macedonia: the new draft law, its content, advancement and comparison</i> , paper in the international conference UBT 6 th Annual International Conference, 27-29 October 2017, Durres, Albania;	6.0
3.3.	<i>Liria e shprehjes dhe diskriminimi në media në R. e Maqedonisë</i> , The Heritage, Universiteti ndërkombëtar i Strugës, Numër 17, 2017;	6.0
3.4.	<i>Promovimi i të drejtave të njeriut nëpërmjet arsimit: Pse është e rëndësishme të mësojmë për të drejtat seksuale dhe riprodiktive, kontribute pas konsultimeve për arsimin për të drejtat seksuale dhe riprodiktive</i> , Drashko Kostovski, redaktues, Shkup, 2016 (maqedonisht);	2.0
3.5.	<i>Establishment of special judicial mechanisms: case of Macedonia</i> (coauthor with Ermira Mehmeti), paper on the international conference Tradition of the law and the law in transition: social, political and normative processes in a comparative perspectives, 28-29 April 2016, Tirana (in English);	6.0
3.6.	<i>Age discrimination in Macedonia: Legislation and practice vis a vis European Union Law</i> , Vandeplas Publishing, USA, 2015;	6.0
3.7.	<i>Politika ligjvënëse dhe krijimi i normave juridike</i> (ko-autor me Osman Kadriu), Vizione, Vol. 23, 2015, Skopje;	6.0

3.8.	<i>Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë: A paraqet në të vërtetë institucion të mbrojtjes së të drejtave të njeriut? Vizione, Skopje, Vol. 23, 2015;</i>	6.0
3.9.	<i>Age discrimination in the Republic of Macedonia and the approach of the Constitutional court, Academic Journal of Interdisciplinary studies, Vol. 4, No. 2, 2015;</i>	6.0
3.10.	<i>Konventa për të drejtat e fëmijës, The Heritage, Universiteti ndërkombëtar i Strugës, Numër 13, 2014;</i>	6.0
3.11.	<i>Definimi ligjor i rendit publik dhe rëndësia për drejtën ndërkombëtare private, Iusticia Vol. 2, Fakulteti juridik, UT, Tetovo, 2014;</i>	4.0
3.12.	<i>Liria e besimit fetar në Maqedoni: A është ndërtimi i objekteve fetare nga ana e shtetit në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për te drejtat e njeriut, Iusticia, Vol. 1, Fakulteti Juridik, UT, Tetovë, 2013;</i>	4.0
	GJITHSEJ	100

VEPRIMTARI PROFESIONALE APLIKATIVE

Nr.	EMRI I AKTIVITETIT:	Pikët
1.	LIBRA NGA FUSHA PROFESIONALE	
1.1.	<i>Mbrojtja nga diskriminimi në të drejtën ndërkombëtare dhe R. e Maqedonisë, Tetovë, 2015;</i>	8
1.2.	<i>Diskriminimi sipas moshës në të drejtën ndërkombëtare, Tetovë, 2015;</i>	8
	GJITHSEJ	16

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	EMRI I AKTIVITETIT	Pikët
1.	ANËTAR I BORDEVE SHKENCORE	
1.1.	Anëtar i Këshillit Organizativ të Konferencës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (2016);	1.0
1.2.	Anëtar i Këshillit Organizativ të Konferencës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (2017);	1.0

2.	ÇMIM SHKETËROR PËR TË ARRITURA SHKENCORE	
2.1.	Çmimi “13 Nëntori” për vitin 2015 për shkencë dhe publicistikë	5.0
3.	ANËTARË I TRUPAVE PROFESIONAL	
3.1.	Anëtarë i Komisionit për mbrojtje nga diskriminimi, prej vitit 2016-deri sot, me vendim të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.	5.0
	GJITHSEJ	12

REFERENCAT PROFESIONALE TË KANDIDATIT PËR ZGJEDHJE NË THIRRJEN	Pikët
VEPRIMTARIA MËSIMORE-ARSIMORE	177.85
VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE	100.0
VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE	16.0
VEPRIMTARITË ME INTERES MË TË GJERË	12.0
GJITHSEJ	305.85

Tetovë, 01.03.2018

KOMISIONI RECENZUES:

1. Prof. Dr. Ljubomir D. Frçkoski, kryetar

2. Prof. Dr. Blerim Reka, anëtar

3. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar

Drejtuar:
**Këshillit të Rektoratit të
Universitetit të Tetovës**
Tetovë

R E F E R A T

për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët “Organizatrat ndërkombëtare” dhe “Zgjidhja paqësore dhe jashtgjyqësore e kontesteve” në Fakultetin Juridik – Universiteti i Tetovës

Në lidhje me konkursin për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018, të shpallur në gazetata: “Koha” dhe “Нова Македонија”, dhe në web faqen zyrtare të Universitetin e Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar** për lëndët: **“Organizatrat ndërkombëtare” dhe “Zgjidhja paqësore dhe jashtgjyqësore e kontesteve”** në Fakultetin Juridik – Universiteti i Tetovës, me Propozim të Këshillit Mësimor – Shkencor të Fakultetit Juridik nr. 02-1136/1 të datës 06.03.2018, formohet Komisioni recenzues në përbërje:

1. Prof.dr. Ylber Sela– Kryetar, Profesor Ordinar
2. Prof.Dr. Nazmi Maliqi – anëtar, Profesor Ordinar
3. Prof.Dr. Mersim Maksuti – anëtar, Profesor Ordinar

Komisioni recenzues, pas shqyrtimit të dokumentacionit në lidhje me konkursin e lartëpërmendur dhe në përputhje me nenin 121, 124, 125 dhe 131 të Ligjit për Arsimit të Lartë (“Gazeta Zyrtare e RM-së” nr.35/2008, 103/08, 26/09, 83/09, 99/09, 115/10, 17/11, 123/12, 15/13, 24/13, 41/14, 116/14, 130/14 dhe 10/15), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N S I O N

Në konkursin e datës 30.01.2018, të shpallur në gazetata: “Koha” dhe “Нова Македонија”, dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: “Organizatrat ndërkombëtare” dhe “Zgjidhja paqësore dhe jashtgjyqësore e kontesteve”, në thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, u paraqiten këto kandidat: Doc.dr. Drita M. Fazlia.

1. Doc.dr. Drita M. Fazlia – të dhënat biografike

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja Doc.dr. Drita M. Fazlia është e lindur më 22.07.1984 në Suboticë – R. e Sërbisë. Shkollimin fillor ka kryer në vendlindje, ndërsa shkollen e mesme në Tetovë. Në vitin 2003 u regjistrua në Fakultetin Juridik – programi studimor i shkencave politike, në Universitetin “Shën Kiril dhe Metodij” – Shkup, ku dhe diplomon më 2006. Pas përfundimit të studimeve universitare, kandidatja regjistrohet në studimet e magjistraturës në Fakultetin Juridik – drejtimi E drejta dhe marrdhëniet ndërkombëtare, në Universitetin “Shën Kiril dhe Metodij” – Shkup, ku në vitin 2010 mbrojtë temën e magjistraturës, me temë “Улогата на Европската Комисија во процесот на донесување на одлуки во Европска Унија, dhe fitoi titullin Magjistër i së drejtës ndërkombëtare nën mantorim të Prof.dr Tatjana Petrushevska. Me pas regjistroi studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik “Justinian i I” në Universitetin “Shën Kiril dhe Metodij” në drejtimin e së drejtës ndërkombëtare, nën udhëheqjen e mentores Prof.dr. Tatjana Petrushevska. Më datë 05.09.2012, kandidati Drita M. Fazlia publikisht mbron me sukses disertacionin e doktoraturës me titull: “Спроведување на арбитражните одлуки во меѓународно јавно право, dhe e merr thirrjen shkencore Doktor i Shkencave Juridike.

Kandidatja Doc.dr. Drita M. Fazlia, i dorëzoi këto dokumente: Diplomë të notarizuar për kryerjen e studimeve të ciklit të parë, të studimeve të magjistraturës dhe të studimeve të ciklit të tretë; Vërtetim për njohjen e gjuhës angleze, listë dhe kopje të punimeve shkencore, biografia nga e cila mund të konstatohen aktivitetet permenente në organizime, seminare dhe konferenca të shumta të nivelit shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.

2. Përvoja universitare

Përvoja profesionale e kandidatit Dr. Drita M. Fazlia është siç vijon: Asistent i ri, në marrëdhënie pune të rregullt në Fakultetin Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, e zgjedhur me Vendim nr. 04-2691/1 nga data 26.12.2007. Më datë 21.02.2013 zgjedhet në thirrjen mësimore-shkencore Docent, me Vendimi nr. 04-1918/1, në lëndët: Organizatat ndërkombëtare dhe Zgjidhja paëqore e kontestve ndërkombëtare. Nga viti 2013 ka qenë e angazhuar edhe si mësimdhënëse në studimet Master në lëndë: E drejta e arbitrazhit, Organizatat ndërkombëtare, Zgjidhja paqësore e kontesteve. Nga viti 2013 kandidatja është anëtare e Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës.

3. Përvoja Profesionale

Në periudhën 2003-2006 ka qenë e angazhuar në Institute for Democracy “Societas Civilis” Skopje (IDSCS); 2005-2006 e angazhuar në marrëdhënie pune të rregullt në JP “Gazeta Zyrtare e RM – Sektori baza e të dhënave; 2006-2008 e angazhuar në marrëdhënie pune të rregullt në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së RM – zëdhënëse dhe udhëheqëse e

njesisë për protokol, marrdhënie me publikun dhe përkthim; 2007-2012 e angazhuar në marrdhënie pune të rregullt si asistente e re, me Vendim nr. 04-2691/1 nga data 26.12.2007; nga 2013 – 2018 me Vendimi nr. 04-1918/1 zgjidhet **Docent**, për lëndët: Organizatat ndërkombëtare dhe Zgjidhja paqësore e kontesteve, në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës;

Kandidatja ka qenë: Anëtare e komisionit për themelimin e Institutit për trashigimin shpirtërore e kulturore të shqiptarëve – 2007; është **Anëtarë i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës**, nga viti 2012; është Shef i programit studimor të drejtësisë **të Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës**, nga 2017- vazhdon; Me vendim nr. 12-35/3 të dates 30.04.2015 nga ana e Këshillit për akreditim dhe avaluim të arsimit të lartë akreditohet për mentor të kandidatëve të ciklit të Master studimeve; është **Udhëheqës shkencor** - Mentore i më shumë se dhjetë kandidatëve të studimeve Master, në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës; është **Udhëheqëse shkencore** - Mentor i më shumë se dhjetë kandidatëve në studimet të shkencave politike në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës; ka qenë disa herë anëtare e komisionit për transfer të studentëve dhe anëtare e Komisionit për verifikimin e dokumenteve të administratës së Fakultetit Juridik me të cilët vërtetohet diplomimi i studentit.

Kandidatja është po ashtu: anëtare i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (**International Journal of Legal Sciences**) "**JUSTICIA**" të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga data 03.09.2012; Anëtare e Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare për shkencat shoqërore - (**International magazine for social sciences**) "**VIZIONE**" nga viti 2017; Me Vendim nr. 13-1724/1 të dates 30.12.2016 emërohet Koordinator e Klubit debatues të Fakultetit Juridik të UT; ka qenë Kryetare e komisionit për përpilimin e Elaboratit të programit studimor të drejtësisë miratuar në Këshillin mësimor – shkencor të realizuar më 01.02.2018; Anëtare e komisionit për përpilimin e elaboratit të studimeve të Doktoraturës së Fakultetit Juridik – UT – Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës; Antare e Komisionit recenzues të një asistent doktorantes; Përgjegjëse për çështjet juridike në “Sejvi Production” nga 2014 për më shumë projekte; Më datë 12.10.2016 Fiton çmim për arrituarat shkencore – çmimi “Shkenctare e re e vitit” nga FRI – Shkup;

4. Aktivitetet shkencore dhe profesionale

Kandidatja Doc.dr. Drita M. Fazlia ka marrë pjesë në këto projekte shkencore dhe profesionale: 25.12.2013, pjesëmarrja në tribunën shkencore “*Kundër dhunës për paqë dhe bashkëjetesë në Republikën e Maqedonisë*”, organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës; 22.01.2014, pjesëmarrja në tribunën shkencore “*Çfarë*

Presidenti i duhet Republikës së Maqedonisë”, organizuar nga Fakulteti Juridik-Universiteti Shtetëror i Tetovës; 12.03.2014, Koordinator dhe pjesëmarrës në Konferencën shkencore ndërkombëtare *“Shteti Juridik dhe Demokracia”*, organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës; 20.09.2014, pjesëmarrëse në Konferencën shkencore ndërkombëtare *“E drejta dhe kultura politike si faktor ndikues në ndërtimin e shtetit modern”*, organizuar nga Instituti për studime ligjore dhe demokratike, Gjilan; 25.04.2015, pjesëmarrëse në Konferencën shkencore ndërkombëtare *“After Communism. East and West under Scrutiny”*, organizuar nga University of Craiova; Pjesëmarrëse në realizimin e projektit të Finansuar na Fond D Alamber, realizuar nga Instituti Francez në Shkup, USHT, Aleanca Franceze në Tetovë dhe Ambasada e Francës në RM, qershor 2015; 7.03.2015, pjesëmarrëse në Konferencën shkencore ndërkombëtare *“Rule of Law and Public Safety Factor Contributing to Regional Economic Cooperation”*, organizuar nga Instituti për studime ligjore dhe demokratike; angazhuar për realizimin e projektit organizuar nga Asociacioni për Afriminin e Gruas lidhur me ditën ndërkombëtare kundër dhunës në familje; 13-14 shtator 2015, pjesëmarrja në konferencën shkencore ndërkombëtare *“Universality, Globalization and The Rule of Law”*, organizuar Fakulteti Juridik në Universitetin e Tetovës; Realizuese e puntorisë *“Dhuna në shekullin XXI dhe sfidat e shtetit për parandalimin e saj”*, Qendra e AAG – Shkup, 24.11.2015; Pjesëmarrja dhe moderimi i tribunës shkencore me temë: *“Ndikimi i proceseve integruese euro-atlantike në marrëdhëniet ndëretnike”*, organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës dhe Këshilli Euroatlantik i Maqedonisë, realizuar më datë 06.10.2016; 09.04.2016, pjesëmarrëse në konferencën ndërkombëtare *“Scientific Challenges for Sustainable Development”*, Strugë, 14.10.2016 pjesëmarrëse në Konferencën e parë Ballkanike *“Pozita, sfidat dhe perspektivat e gruas në Ballkan”* organizuar nga AAG – Shkup; Pjesëmarrja në Konferencën e tretë ndërkombëtare shkencore të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, për datën 18-19 nëntor 2016, me temë: *“Drejtësia dhe Sfidat e Proceseve Euroatlantike” - “The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes”*; 02-02.05.2017 Pjesëmarrje në *“Klubin debates”* organizuar nga Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës; 5-6.10.2017 Ligjeruese në seminarin vjetor organizuar nga Asociation for Women Affirmation, *“Eduko me dashuri dhe përkushtim”*; 16.05.2017 pjesëmarrje në trajnim organizuar nga Asociacioni për Afriminin e Gruas dhe Qendrës për Mirkuptim dhe Bashkëpunim Institucional, në kuadër të 15 majit – Ditës botërore të familjes. 26.05.2017 pjesëmarrje në puntorin – Shkëmbimin e praktikave në lidhje me teknikat e vlerësimit të programeve studimore dhe zbatimin e tyre në praktik” e financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Twinning Project *“Developing cooperation between higher education instituciones, the private sector and relevant public bodies”*; 12.10.2017, Pjesëmarrje në Tribunën me temë: *“Të drejtuarit e dialogut rinor në promovimin e demokracisë, në dritën e integritetit euroatlantik”, “Straightening the youth dialogue for democracy promotion in the light of Euro- Atlantic integration”*. Organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë në partneritet me Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës;

5. Listë e punimeve shkencore dhe botimeve profesionale të publikuara

- „Состојбата на човековиот капитал во Република Македонија и предизвици за идното унапредување,, Political Thought – The Challenges of Education Policy, nr.33, viti 9, Shkup 2011;
- „Kompetencat e Komisionit Evropian dhe raporti i tij me RM”, Revistë shkencore dhe profesionale juridike ULPIANUS, nr. 1/2011,
- „Капацитетот на Европска Централна Банка како предизвик за идното стабилизирање на еврото,, Political Thought – The future of Euro: Challenges for financial Stability – nr. 37, viti 10, 2012
- “Согласноста за меѓународна јавно – правна арбитража,, PRAVNIK, nr. 243- 244, viti 21, gusht 2012,
 - “Право на вето недемократски инструмент во однос на референдумот,, EVRODIJALOG, nr. 17, 2013,
 - “Пажити i palëve për të drejtën kompetente në procesin e zgjidhjes së kontesteve, JUSTICIA, nr.1, 2013,
- “E drejta e barazisë sovranе dhe kufizimi i saj në anëtarësimin në NATO”, VIZIONE, nr.22, 2014 Shkup,
 - “NDIKIMI I NDËRMJETËSIMIT PËR ZGJIDHJET PAQËSORE TË KONTESTEVE NDËRKOMBËTARE”, JUSTICIA, nr 2, 2014,
- „The Role of negotiation in Conflict Resolution” Political Thought – Models of Secure and Stable Integration: A Hundered Years after the First World War, nr. 46, viti 12, 2014 Shkup,
- “Debating Sovereignty: Self – Encounters of the Limitation in the Implementation of International Law”, Revista de Stiinte Politice, nr. 48, 2015,
- “Demokracia dhe e drejta e vetos”, JUSTICIA, nr 3-4, 2015,
- “ Ndikimi i procesit euro-integrues në tejkalimin e fazes së tranzicionit VIZIONE,nr 23, 2015
 - “Sistemi Evropian mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut – Republika e Maqedonisë”, Heritage, 2016
 - “Operacionet e NATO-së në Republiken e Maqedonisë pas konfliktit të 2001” Revista Shkencore Ndërkombëtare CENTRUM, nr. 7/2017
 - “Të drejtat e fëmijëve në bazë të Konventës së OKB-së dhe shkaqet që e determinojnë delikvencën e të miturve” JUSTICIA, 7/2017

6. LIBRA TË BOTUARA

- Organizatat ndërkombëtare, Arbëria Dizajn, 2014, Tetovë;
- Zgjidhja paqësore e kontesteve ndërkombëtare, Arbëria Dizajn, 2014, Tetovë;
- Ligjerata të autorizuar nga lënda E drejta e Arbitrazhit.

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	80.29
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	112

3.	Veprimtaria profesionle-aplikative	25
4.	Veprimtaria me interes më të gjërë	25
	Gjithësej	242.29

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recenzues vlerëson se kandidatja **Doc. dr Drita M. Fazlia** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Indordinar**, duke u referuar në përvojën e deritanishme profesionale dhe pedagogjike. Duke marrë parasysh aktivitetin gjithëpërfshirës të kandidates nga sfera e së drejtës, si dhe kontinuitetin në studimet dhe thirrja docent nga fusha përkatëse, pjesmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, projekte hulumtuese, të arriturat shkencore të prezentuara në disertacionin e doktoraturës, punimin e magjistraturës, punimt shkencore dhe profesionale të publikuara, Komisioni vlerëson se Doc.dr. Drita M. Fazlia i plotëson të gjitha kushtet për thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar, sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recenzues ka nderin t'i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doc.dr. Drita M. Fazlia** të zgjidhet Profesor për lëndët: **“Organizatrat ndërkombëtare”** dhe **“Zgjidhja paqësore dhe jashtgjyqësore e kontesteve”** në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në thirrjen mësimore-shkencore Profesor Inordinar.

Komisioni Recenzues:

1. Prof.dr. Ylber Sela – Kryetar
2. Prof.dr. Nazmi Maliqi – anëtar
3. Prof.dr. Mersim Maksuti – anëtar

SHTOJCË
PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE
DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidatja: **Doc.dr. Drita M. Fazlia**
 Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**
 Programi studimor: **Studime të drejtësisë**

VEPRIMTARIA MËSIMORE SHKENCORE

Nr.Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Mbajtja e Ligjeratave	
I.1	Organizatat ndërkombëtare (2+1, Tetovë, 5 semestra)	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
I.2	Organizatat ndërkombëtare (2+1, Shkup, 5 semestra)	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
I.3	Organizatat ndërkombëtare (2+2, Shkencat politike, 5 semestra)	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
I.4	E drejta e arbitrazhit (2+1, Tetovë, 5 semestra)	$2 \times 15 \times 5 \times 0.04 = 6$
I.5	E drejta e arbitrazhit (2+1, Shkup, 4 semestra)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.6	Zgjidhja e konflikteve (2+2, Shkup, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
I.7	Zgjidhja e konflikteve (2+2, Tetovë, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
I.8	Organizatat ndërkombëtare (Cikli Master, 2+1, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.05 = 4.5$
I.9	Zgjidhja paqësore e kontesteve ndërkombëtare (Cikli master, 2+1, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.05 = 3$
I.10	E drejta e arbitrazhit (Cikli master, 2+1, 5 semestra)	$2 \times 15 \times 5 \times 0.05 = 7.5$
I.11	E drejta ndërkombëtare e arbitrazhit (cikli master, 2+1, 1 semetër)	$2 \times 15 \times 1 \times 0.05 = 1.5$
II	Mbajtja e Konsultimeve	
II.1	Organizatat ndërkombëtare (2+1, Tetovë, 5 semestra)	$25 \times 5 \times 0.002 = 0.25$
II.2	Organizatat ndërkombëtare (2+1, Shkup, 5 semestra)	$25 \times 5 \times 0.002 = 0.25$
II.3	Organizatat ndërkombëtare (2+2, Shkencat politike, 5 semestra)	$25 \times 5 \times 0.002 = 0.25$
II.4	E drejta e arbitrazhit (2+1, Tetovë, 5 semestra)	$25 \times 5 \times 0.002 = 0.25$
II.5	E drejta e arbitrazhit (2+1, Shkup, 4 semestra)	$20 \times 4 \times 0.002 = 0.16$
II.6	Zgjidhja e konflikteve (2+2, Shkup, 2 semestra)	$10 \times 2 \times 0.002 = 0.04$
II.7	Zgjidhja e konflikteve (2+2, Tetovë, 3 semestra)	$15 \times 3 \times 0.002 = 0.09$
III	Mentor i Punimeve të diplomës dhe të Masterit	
III.1	Mentorim të punimeve të Masterit	$10 \times 2 = 20$
III.2	Mentorim të punimeve të diplomës	$8 \times 2 = 16$
IV	Anëtar në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të punimeve të diplomës dhe të masterit	
IV.1	Kryetare dhe anëtare të komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të Masterit	$23 \times 1 = 23$

IV.2	Kryetare dhe anëtare të komisionit për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të diplomës	11x1=11
	GJITHËSEJ:	80.29

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr.Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Pjesëmarrja në Projekte Shkencore	
I.1	Pjesëmarrëse në realizimin e projektit të finansuar na Fond D Alamber, realizuar nga Instituti Francez në Shkup, USHT, Aleanca Franceze në Tetovë dhe Ambasada e Francës në RM, qershor 2015	2
I.2	Pjesëmarrja dhe moderimi i tribunës shkencore me temë: <i>"Ndikimi i proceseve integruese euro-atlantike në marrëdhëniet ndëretnike"</i> , organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës dhe Këshilli Euroatlantik i Maqedonisë, realizuar më datë 06.10.2016;	2
I.3	14.10.2016 Organizatore dhe pjesëmarrëse në Konferencën e parë Ballkanike "Pozita, sfidat dhe perspektivat e gruas në Ballkan" organizuar nga AAG - Shkup	2
I.4	02-02.05.2017 Organizatore dhe Pjesëmarrëse në "Klubin debatus" organizuar nga Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës,	2
I.5	16.05.2017 Pjesëmarrje në trajnim organizuar nga Asociacioni për Afriminin e Gruas dhe Qendrës për Mirkuptim dhe Bashkëpunim Institucional, në kuadër të 15 majit – Ditës botërore të familjes	2
I.6	26.05.2017 Pjesëmarrëse e puntorisë – Shkëmbimin e praktikave në lidhje me teknikat e vlerësimit të programeve studimore dhe zbatimin e tyre në praktik" e financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të Twinning Project "Developing cooperation between higher education institutions, the private sector and relevant public bodies"	2
I.7	12.10.2017, Pjesëmarrje në Tribunën me temë: "Të drejtuarit e dialogut rinor në promovimin e demokracisë në dritën e integritetit euroatlantik", "Straightening the youth dialogue for democracy promotion in the light of Euro-Atlantic integration". Organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë në partneritet me Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës	2
I.8	22.01.2014, Pjesëmarrje në tribunën shkencore "Çfarë Presidenti i duhet Republikës së Maqedonisë", organizuar	2

	nga Fakulteti Juridik-Universiteti Shtetëror i Tetovës	
I.9	Realizuese e puntorisë “Dhuna në shekullin XXI dhe sfidat e shtetit për parandalimin e saj”, Qendra e AAG – Shkup, 24.11.2015	2
I.10	5-6.10.2017 Ligjeruese në seminarin vjetor organizuar nga Asociation for Women Affirmation, “Eduko me dashuri dhe përkushtim”	2
II	Artikuj me Rezultate Shkencore Origjinale, të publikuara në Revistë, Referente Shkencore/Profesionale me Bord Redaktues Ndërkombëtar	
II.1	“Право на вето недемократски инструмент во однос на референдумот,, EVRODIJALOG, nr. 17, 2013	6
II.2	“Pajtimi i palëve për të drejtën kompetente në procesin e zgjidhjes së kontesteve, JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (Justicia, International Journal of Legal Sciences) nr.1, 2013, UDC:34, ISSN 1857 – 8454 (Print)	6
II.3	“E drejta e barazisë sovrane dhe kufizimi i saj në anëtarësimin në NATO”, VIZIONE, International magazine for social sciences nr.22, 2014 Shkup, UDC 316,33,32, ISSN 1409-8962, ISSN 1857-9221	6
II.4	“NDIKIMI I NDËRMJETËSIMIT PËR ZGJIDHJET PAQËSORE TË KONTESTEVE NDËRKOMBËTARE”, JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (Justicia, International Journal of Legal Sciences) nr 2, 2014, UDC:34, ISSN 1857 – 8454 (Print)	6
II.5	„The Role of negotiation in Conflict Resolution” Political Thought – Models of Secure and Stable Integration: A Hundered Years after the First World War, nr. 46, viti 12, 2014 Shkup	6
II.6	“Debating Sovereignty: Self – Encounters of the Limitation in the Implementation of International Law”, Revista de Stiinte Politice, nr. 48, 2015	6
II.7	“Demokracia dhe e drejta e vetos”, JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (Justicia, International Journal of Legal Sciences) nr 3-4, 2015, UDC:34, ISSN 1857 – 8454 (Print)	6
II.8	“ Ndikimi i procesit euro-integrues në tejkalimin e faze së tranzicionit” VIZIONE (International magazine for social sciences),nr 23, 2015 Shkup, UDC 316,33,32, ISSN 1409-8962, ISSN 1857-9221	6
II.9		
II.10	“Sistemi Evropian mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut– Republika e Maqedonisë”, Heritage, 2016	

II.11	“Operacionet e NATO-së në Republikën e Maqedonisë pas konfliktit të 2001” Revista Shkencore Ndërkombëtare CENTRUM, nr. 7/2017	6
II.12	“Të drejtat e fëmijëve në bazë të Konventës së OKB-së dhe shkaqet që e determinojnë deliktuencën e të miturve” JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës (Justicia, International Journal of Legal Sciences) nr. 7/2017, UDC:34, ISSN 1857 – 8454 (Print)	6
III	Abstrakt i botuar në librin e mbstrakteve nga konferencat shkencore	10x2=20
	GJITHËSEJ:	112

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. tit Rendor	Emri i Aktivit	Pikët
I.	Libra dhe publikime shkencore dhe profesionale	
I.1	“Organizatrat ndërkombëtare”, libër universitar, botuar 2014, Botues: “Arbëria Dizajn”, Recenzentë: Prof.dr. Arif Riza dhe Prof dr. Erija Canaj Bana	10
I.2	“Zgjidhja paqësore e kontesteve ndërkombëtare”, libër universitar, botuar 2014, Botues “Arbëria Dizajn”, Recensent: Prof.dr. Rizvan Sulejmani, Prof.dr. Nazmi Maliqi	10
I.3	“E drejta e arbitrazhit” – ligjerata të autorizuar	5
	GJITHËSEJ:	25

VEPRIMTARIA ME INTERES MË TË GJËRË

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1.	Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) " JUSTICIA " të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga data 03.09.2012	2
2.	Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare për shkencat shoqërore - (International magazine for social sciences)	2

	"VIZIONE" nga viti 2017	
3.	Shef i programit studimor të drejtësisë të Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës , nga 2017- vazhdon	2
4.	Me Vendim nr. 13-1724/1 të dates 30.12.2016 emërohem Koordinator e Klubit debatues të Fakultetit Juridik të UT	2
5.	Me vendim nr. 12-35/3 të dates 30.04.2015 nga ana e Këshillit për akreditim dhe avaluim të arsimit të lartë akreditoem për mentor të kandidatëve të ciklit të Master studimeve	2
6.	Anëtar i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës , nga viti 2012	1
7.	Disa herë anëtare e komisionit për transfer të studentëve dhe anëtare e Komisionit për verifikimin e dokumenteve të administratës së Fakultetit Juridik me të cilët vërtetohet diplomimi i studentit	2
8.	Anëtare e komisionit për përpilimin e Elaboratit të programit studimor të drejtësisë miratuar në Këshillin mësimor – shkencor të realizuar më 01.02.2018	2
9.	Anëtare e komisionit për përpilimin e elaboratit të studimeve të Doktoraturës së Fakultetit Juridik – UT – Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës	2
10.	Pregatitja e elaborateve të programit studimor të ciklit të dytë – Studime të drejtësisë në Fakultetin Juridik - UT	2
11.	Anëtare e Komisionit recenzues të një asistent doktorant	2
12.	Konsulente dhe përgjegjëse për çështjet juridike në “Sejvi Production” nga 2014	2
13.	Çmim për te arrituarat shkencore – çmimi “Shkenctare e re e vitit” nga FRI – Shkup	2
	GJITHËSEJ	25

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	80.29
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	112
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative	25

4.	Veprimtaria me interes më të gjërë	25
	GJITHËSEJ	242.29

Komisioni Recenzues:

- 1. Prof.dr. Ylber Sela – Kryetar**
- 2. Prof.dr. Nazmi Maliqi – anëtar**
- 3. Prof.dr. Mersim Maksuti – anëtar**

Drejtuar:
**Këshillit të Rektoratit të
Universitetit të Tetovës**
Tetovë

REFERAT

Për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët:

1. « Teoritë e modernizmit dhe media globale »,
2. « Redaktimi në media »,
3. « Komunikimi dhe marrëdhëniet publike »,

në Programin Studimor të Gazetarisë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, www.unite.edu.mk dhe në gazetën ditore “Koha” me datë 31.01.2018, për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar** për lëndët: « **Teoritë e modernizmit dhe media globale** », « **Redaktimi në media** » dhe « **Komunikimi dhe marrëdhëniet publike** », në **Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës**, me Propozim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik nr. 13-178 /3 të datës 20.02.2018 dhe me Vendim të Këshillit të Rektoratit nr. 02-1136/1 të datës 06.03.2018 formohet Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof. Dr. YLBER SELA - Kryetar
2. Prof. Dr. BASHKIM GJERGJI - anëtar
3. Prof. Dr. FERAT POLISI - anëtar

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenet 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsimit të Lartë (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve dhe asistent-doktorantëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

RECENSION

Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës me datë 30.01.2018 në web faqen www.unite.edu dhe në gazetën ditore “Koha”, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët:

1. « **Teoritë e modernizmit dhe media globale** », 2. « **Redaktimi në media** » dhe 3. « **Komunikimi dhe marrëdhëniet publike** », në thirrjen mësimore-shkencore

Profesor Inordinar, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, **u paraqit kandidatja:**

2. Doc. Dr. Aurora Karameti

Sipas dokumentacionit të dorëzuar, kandidatja **Doc. Dr. Aurora Karameti** (Ndrio) ka lindur më 04.11.1974 në Lushnjë, Republika e Shqipërisë. Studimet universitare i ka përfunduar më 15.07.2000 në *Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës* në degën “Gazetari” dhe është diplomuar “Gazetar”. Studimet e masterit i ka përfunduar më 15.07.2005 në *Fakultetin Filologjik të Universitetit të Tiranës* me mbrojtjen e tezës: “Pasqyrimi në media i konfliktit në Maqedoni: Janar-Gusht 2001”. Më 28.03.2011 mori titullin “Doktor i shkencave të informacionit dhe komunikimit” nga *Universiteti Sorbonne Nouvelle Paris 3* në Francë ku mbrojti publikisht tezen “Shtypi shqiptar dhe ndërkombëtar dhe mbulimi i aktualitetit në Maqedoni : Analizë e një korpusi shumë-gjuhësor nga janari në gusht 2001”.

PERVOJA UNIVERSITARE

Karrierën universitare kandidatja Doc. Dr. Aurora Karameti e ka nisur prej 01.12.2003 si mësimdhënëse në Fakultetin e Shkencave dhe Teknologjive të Komunikimit, në Departamentin e Komunikimit, të Universitetit të Europës Jug-Lindore në Tetovë, ku ka marrë edhe thirrjen mesimore-shkencore Asistent dhe ku ka punuar deri më 20.09.2011. Prej 20.03.2005 deri më 30.09.2005 kandidatja ka punuar në Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare po të UEJL, si zyrtare e ngarkuar me Shkëmbimet Akademike dhe Studentore. Nga 01.02.2012 kandidatja u angazhua si mësimdhënëse me kohë të pjesshme në Programin Studimor të Gazetarisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës. Me Vendim të Rektoratit të Universitetit Shtetëror të Tetovës Nr. 046207/1 të datës 27.12.2012 kandidatja mori thirrjen DOCENT për lëndët : 1. « Teoritë e modernizmit dhe media globale » dhe « Redaktimi në media », në Programin Studimor të Gazetarisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, ku edhe i ligjëron aktualisht bashkë me lëndët “Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor” dhe “Psikologjia e komunikimit”. Në Universitetin e Tetovës kandidatja është angazhuar në mësimdhënie edhe në Programin Studimor të Kriminalistikës ku mban lëndën « Komunikimi dhe marrëdhëniet publike » si dhe në studimet Master, prej vitit 2014, në të gjitha Programet e Drejtësisë si edhe në Programin e Gazetarisë ku ka mbajtur lëndët : « Etika në administratën publike », « Metodologjia e hulumtimit shkencor », « Gazetaria televizive », « Gazetaria e profilizuar », « Metodatat e hulumtimit gazetaresk dhe mediatik », « Produksioni digjital në mediat televizive dhe online ». Që prej vitit akademik 2014-2015 kandidatja është e angazhuar si mësimdhënëse part-time në Shkollën e Gazetarisë së Parisit, Programi i Mësimdhënies në Distançë (*Ecole Supérieure de Journalisme de Paris, EAD-Programme d’enseignement à distance*).

Gjatë karrierës akademike Doc. Dr. Aurora Karameti është avancuar profesionalisht me disa programe të financuara nga institucione të vendit dhe të huaja. Në vitin 2004 (11-25 Shtator) ka qëndruar në *Indiana University-Perdue University*, Indianapolis, SHBA, në një program shkëmbimi eksperience. Në vitin 2006 (janar-maj) ka ndjekur programin JFDP, të financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit për kërkime dhe shkëmbim eksperience në *Florida State University*, SHBA. Në vitet 2005-2007 ka ndjekur programin dy-vjecar të trajnimit për

teknologji, gjuhë angleze dhe metodologji mësimdhënieje nga *Indiana University*, SHBA dhe *Universiteti i EJL*, Tetovë.

PËRVOJA PROFESIONALE :

- Kandidatja Doc. Dr. Aurora Karameti ka nisur karrierën profesionale si gazetare me kohë të pjesshme në Departamentin e Lajmeve të Jashtme të Televizionit Publik Shqiptar në Tiranë.
- Më pas ka punuar si gazetare dhe moderatore e emisioneve informative në disa prej televizioneve më të rëndësishëm private në vitet 2000-2003 në Tiranë si TV Koha, TV Arbëria, TV Alsat.
- Kandidatja është njohëse e institucioneve Europiane. Në vitin 2000 (03 Prill-30 Qershor) ka kryer një stazh në Departamentin e Marrëdhënieve Publike të Këshillit të Europës në Strasburg, Francë. Në kuadër të përvijës, ka realizuar me sukses projektin e krijimit të broshurës “Këshilli i Europës”, në gjuhën shqipe.
- Në vitin 2004, kandidatja ka fituar financim për projektin e saj « Service Learning project : High schools and the local community for protecting the environment », nga Universiteti i Indianës në SHBA.
- Gjithashtu nga Universiteti i Indianës, është përzgjedhur për një Projekt Pilot, si bashkë-trajtnesja e parë e Qendrës së Karrierës së UEJL, në vitin 2004, ku ka mbajtur ligjërata mbi Zhvillimin e Karrierës, një kurs i dizajnuar nga profesori David Randall.
- Kandidatja ka mbykqyrur botimin e gazetës së studenteve të Shkencave të Komunikimit në UEJL, CAMPUS, nga viti 2004 deri në vitin 2011.
- Në kuadër të projektit Tempus mbi zbatimin e sistemit ECTS (European Credit Transfer System), kandidatja ka qenë përfaqësuese e UEJL në aktivitetet e zhvilluara me universitetet partnere si Politecnico di Torino, Shën Kirili dhe Metodi Shkup dhe Universiteti i Manastirit, përgjatë vitit 2005.
- Në vitin 2012 kandidatja ka qenë e angazhuar nga kompania ND Ballkan në Tetovë, në një projekt për studim të tregut të medias në Maqedoni dhe propozim për avancimin e medias në gjuhën shqipe, në vitin 2012.
- Në vitin 2013 kandidatja është angazhuar si analiste nga MEDIAMORPHOSIS për shkrimin e artikujve kritike mbi produksionin e medias në Maqedoni në kuadër të programit « Strengthening Media in Macedonia - Media Fact-Checking Service Component » financuar nga USAID.
- Në vitin 2016 ka marrë pjesë në projektin arsimor të financuar nga Erasmus+ TEL4SL (Technology Enhanced Learning for Social Literacy), në Values University, në Mafra të Portugalisë.

Kandidatja Doc. Dr. Aurora Karameti në konkurs i dorëzoi këto dokumente:

1. Diplomën e Doktoratës (kopje të përkthyer dhe noterizuar) DHE Vërtetimin e Nostrifikimit të saj,
2. Punimin e doktoratës,
3. Vendimin për zgjedhje rizgjedhje në Thirrjen mësimore-shkencore Docent (kopje të noterizuar),

4. Listën e punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara në revista shkencore DHE kopje të punimeve të publikuara,
5. Kopje të certifikatave nga konferencat shkencore,
6. Biografi të shkurtër (CV),
7. Vërtetim për njohje të gjuhës së huaj,
8. Çertifikatë nga libri amzë i të lindurve,
9. Çertifikatë shtetësie.

PJESEMARRJA NË AKTIVITETET SHKENCORE:

Që prej thirrjes Docent, kandidatja ka vazhdimësi intensive në aktivitetin kërkimor-shkencor. Ajo ka marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare dhe rajonale, me prezantime të punimeve origjinale, të paraqitura në vijim:

- Artikull “The linguistic hegemony as represented by the media in Macedonia and Kosovo, and the discrepancy between these two former Yugoslav countries, both aspiring to integrate the EU”. Pranuar për prezantim në konferencën ndërkombëtare Global Problems & Community Praxis: Local, National, and International Approaches to Peace and Transcultural Communication, organizuar nga Qendra për Paqe dhe Komunikim Transkulturore e USHT dhe Northern Illinois University ne SHBA që do të mbahet në NIU më 19 - 20 prill 2018.
- “Transformimet mediatike dhe metodologjia e kërkimit në shkencat e informacionit dhe komunikimit”. International conference on Communication and Media Studies - ICCMS 2017. Prishtinë, 2017.
- “The peculiar power of public word in Macedonia and its ramifications in the country’s level of democracy”. Konferencë ndërkombëtare: The law and challenges of the euro-Atlantic processes, Fakulteti Juridik, Universiteti i Tetovës, 2016.
- “Geopolitical genesis of international public agenda as an impact of Vienna Congress”. Konferencë ndërkombëtare Vienna Congress and the Balkans 200 years later (1815-2015), Institute for Political and International Studies, Shkup, 2015.
- “National culture, multiculturalism and the Albanian media in Macedonia: modern global models and local issues”. Konferencë ndërkombëtare Communication and Media Studies organizuar nga ESJ Paris, IPAG Business School Paris, Universiteti i Tiranës dhe Kolegji AAB, Prishtinë, 2015.
- “Reporting environmental pollution: Media and public discourse vs. political discourse in the Republic of Macedonia”. Konferencë ndërkombëtare After Communism East and West under Scrutiny, University of Craiova, Rumani, 2015.
- “News media as a social factor for law enforcement in the Republic of Macedonia”. Konferencë ndërkombëtare Humanities and social sciences ICHSS 2014, organizuar nga Mediterranean Center of Social and Educational Research, Rome-Itali dhe University of Montenegro, Budva,

2014.

- “Masmedia ne rolin e parapriresit te ndryshimeve shoqerore”. Konferencë ndërkombëtare Rule of Law and Democracy, Universiteti i Tetovës, 2014.
- The right and the political culture as a factor influencing the construction of the modern state. Konferencë rajonale, Gjilan-Kosovë, 2014.
- “The contribution of US programs in the development of communication sciences as a new field of study in Macedonia”. Seminar ndërkombëtar The role of the United States in the development of higher education and democratisation of the society in Macedonia, USHT, 2013. <http://aassee.eu/index.php/aassee-news/>

Aktiviteti kërkimor-shkencor i kandidates Doc. Dr. Aurora Karameti konfirmohet edhe me punimet shkencore të botuara në **tre revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti** si edhe revista apo botime kolektive shkencore ndërkombëtare. Të gjitha publikimet me karakter kërkimor-shkencor prezantohen në vazhdim të këtij referati:

LISTË E PUNIMEVE SHKENCORE DHE BOTIMEVE PROFESIONALE TË PUBLIKUARA:

- “Le traitement médiatique et socio-politique de la question de migration transitoire en Macédoine”. *Regards croisés sur la crise migratoire vue par des intellectuels des deux rives de la Méditerranée*, Vepër kolektive. Botues: Forum de Recherche sur les Médias en Méditerranée, 2017 (ne proces botimi). Paris, Francë.
- “Reporting environmental pollution: Media and public discourse vs. political discourse in the Republic of Macedonia”. *Revue des sciences politiques* (Revista de stiinte politice), Nr. 43, 2015, Craiova-Rumani.
- « Multiculturalism and the Albanian-speaking media in Macedonia : Modern global models and local issues ». *Thesis*. Nr. 2, 2015, fq. 67-78. KAAB, Pristinw-Kosovë.
- “Geopolitical genesis of international public agenda as an impact of the Vienna Congress”. *Vienna Congress and the Balkans: 200 years later (1815-2015)*. Fq. 19-29. Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Ambasada e Austrisë, Shkup, 2015.
- “News media as a social factor for law enforcement in the Republic of Macedonia”. *Mediterranean Journal of Social Sciences*, Vol. 5, Nr. 13, 2014. MCSER Publishing, Romë-Itali.
- **LIBËR**. *Media dhe gjeopolitika e një konflikti etnik*. 282 faqe, 2014. Universiteti Shtetëror i Tetovës.

- “Roli i Televizionit *Alsat-M* si një medium dygjuhësor, për njohjen ndëretnike të audiencës në Maqedoni”. *International journal for social sciences Visione*, Nr. 22 (1) 2014. Fq. 767-772. Shkup.
- “Media në Maqedoni midis krijimit të opinionit dhe pasqyrimit të tij ». *JUSTICIA*, Vol.2, Nr.1, 2014, Tetove. ISSN 1857-8454
- Recension per librin : *Trileri i O.J. Schmitt për Kosovën*, i autorit Ibrahim Kelmendi. Buzuku & Epoka e Re, Prishtinë, Kosovë.
- “The image of the Balkans in the transnational news agencies”. *Diskutime (Reviste nderkombetare)*, Tetove: ADSH, 2012. ISSN: 1857 825X.
- **LIBËR.** *Guerre, médias et géopolitique: les influences réciproques. Le conflit de Macédoine sous le regard de la presse internationale et albanophone.* 376 p. Saarbrücken: Lambert Academic Publishing, 2011.
http://www.amazon.com/gp/product/3846515280/ref=cm_sw_r_fa_alp_weslpb1MCVNQS
- “The MUN Conference: Spring 2011”. *Model United Nations: A Model for Extra Curricular Activity.* Macedonian American Alumni Association. 2011. Shkup. ISBN 978-608-65257-2-9.
- “Studimet e komunikimit në UEJL dhe tregu i mediave në Maqedoni”. *Studime albanologjike: Mediat shqiptare ne tranzicion* (Anetare e bordit redaktues: Reviste nderkombetare) Tirane: Universiteti i Tiranës-Departamenti i Gazetarisë, 2010.
- Komunikimi publik nëpërmjet shtypit në gjuhën shqipe në Maqedoni. *Komunikimi bashkekohor midis shqiptareve*, Tirane: Universiteti i Tiranës-Departamenti i Gazetarisë, 2009.

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Komisioni recensues pasi vlerësoi kualifikimin e kandidates Doc. Dr. Aurora Karameti (Ndrio) në të gjitha ciklet e studimeve si dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe akademik në universitete perëndimore me renome në fushën e Informacionit dhe Komunikimit, pasi vlerësoi vazhdimësinë e aktivitetit kërkimor-shkencor shprehur në pjesëmarrje të vazhdueshme në aktivitete shkencore dhe në publikime në revista shkencore ndërkombëtare dhe me faktor impakti, pasi vlerësoi kontributin profesional në mësimdhënie në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve në Universitetin e Tetovës por edhe në institucione me renome botërore siç është Shkolla e Gazetarisë së Parisit (ESJ Paris) dhe universitete të rajonit dhe vlerësoi kompatibilitetin e kualifikimit të kandidates me lëndët mësimore që konkurron në këtë konkurs,

KONSTATON

se kandidatja Doc. Dr. Aurora Karameti (Ndrio) i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, sipas kritereve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doc. Dr. Aurora Karameti** (Ndrio) të zgjidhet **Profesor Inordinar** për lëndët: « Teoritë e modernizmit dhe media globale », « Redaktimi në media » dhe « Komunikimi dhe marrëdhëniet publike » në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës.

K O M I S I O N I R E C E N S U E S :

1. Prof. Dr. Ylber Sela, kryetar

2. Prof. Dr. Bashkim Gjergji, anëtar

3. Prof. Dr. Ferat Polisi, anëtar

SHTOJCË
PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE
DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: **Doc. Dr. Aurora Karameti**
 Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**
Programi studimor: Studime të Gazetarisë,
Programi studimor : Studime të Kriminalistikës

VEPRIMTARIA MËSIMORE SHKENCORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Mbajtja e Ligjëratave në ciklin e parë të studimeve	
1.2	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, Tetovë, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.3	Redaktimi në media (2+1, Tetovë, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.4	Psikologjia e komunikimit (2+1, Tetovë, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.5	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor Tetovë (2+1, Shkup, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.6	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, Shkup, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.7	Redaktimi në media (2+1, Shkup, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.8	Psikologjia e komunikimit (2+1, Shkup, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
1.9	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, Shkup, 5 semestra)	2x15x5x0.04=6
2	Mbajtja e Ligjëratave në ciklin e dytë të studimeve	
2.1	Metodologjia e hulumtimit shkencor. (Drejtimi Civil, Penal, Administrativ, Tetovë, 2+1, 1 semester)	2x15x1x0.05=1.5
2.2	Etika në administratën publike, (Drejtimi Administrativ, Tetovë, 2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.3	Media e profilizuar (Drejtimi Gazetari, Tetovë, 2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.4	Gazetaria televizive (Drejtimi Gazetari, Tetovë, 2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
2.5	Metodologjia e hulumtimit gazetaresk dhe mediatik (Drejtimi Gazetari, Tetovë, 2+1, 1 semester)	2x15x1x0.05=1.5
2.6	Produksioni digjital në mediat televizive dhe online (Drejtimi Gazetari, Tetovë, 2+1, 1 semestër)	2x15x1x0.05=1.5
3	Mbajtja e ushtrimeve në ciklin e parë të studimeve	
3.1	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, Tetovë, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.2	Redaktimi në media (2+1, Tetovë, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.3	Psikologjia e komunikimit (2+1, Tetovë, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.4	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor Tetovë (2+1, Shkup, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.5	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, Shkup, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.6	Redaktimi në media (2+1, Shkup, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
3.7	Psikologjia e komunikimit (2+1, Shkup, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25

3.8	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, Shkup, 5 semestra)	1x15x5x0.03=2.25
4	Përgatitje e lëndës së re	
4.1	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1)	1+1.5=2.5
4.2	Redaktimi në media (2+1)	1+1.5=2.5
4.3	Psikologjia e komunikimit (2+1)	1+1.5=2.5
4.4	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor Tetovë (2+1)	1+1.5=2.5
5	Mbajtja e Konsultimeve	
5.1	Teoritë e modernizmit dhe media globale (2+1, Tetovë, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.2	Redaktimi në media (2+1, Tetovë, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.3	Psikologjia e komunikimit (2+1, Tetovë, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.4	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor Tetovë (2+1, Shkup, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.5	Teorite e modernizmit dhe media globale (2+1, Shkup, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.6	Redaktimi në media (2+1, Shkup, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.7	Psikologjia e komunikimit (2+1, Shkup, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
5.8	Mediumet dhe komunikimi ndërkulturor (2+1, Shkup, 5 semestra)	15x5x0.002=0.15
6	Profesor Vizitor në programin e mësimdhënies në distancë (Online) në ESJ Paris, France, për 8 semestra	8x6=48
7	Profesor Vizitor në Fakultetin Filologjik, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit të Univeristetit të Tiranës, për 1 semester	2
8	Qëndrim studimor në Universitetin e Reims për një vit	3
9	Mentorim i punimeve të Diplomës	5x0.2=1
10	Mentorim i Punimeve të Masterit	1x2=2
11	Anëtar dhe Kryetar në Komisione për Mbrojtjen e Punimeve të Masterit	11x1=11
	Gjithsej:	153.2

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Pjesmarrje në konferenca shkencore vendore, rajonale dhe ndërkombëtare	
1.2	Artikull “The linguistic hegemony as represented by the media in Macedonia and Kosovo, and the discrepancy between these two former Yugoslav countries, both aspiring to integrate the EU”. Pranuar për prezantim në konferencën ndërkombëtare <i>Global Problems & Community Praxis: Local, National, and International Approaches to Peace and Transcultural Communication</i> , organizuar nga Qendra për Paqe dhe Komunikim Transkulturor e USHT dhe Northern Illinois University ne SHBA që do të mbahet në NIU më 19 - 20 prill 2018.	3
1.3	Aurora Karameti. “Transformimet mediatike dhe metodologjia e kërkimit në shkencat e informacionit dhe komunikimit”. <i>International</i>	3

	<i>conference on Communication and Media Studies - ICCMS 2017</i> , Prishtinë, 2017.	
1.4	Aurora Karameti. "Geopolitical genesis of international public agenda as an impact of Vienna Congress". Konferencë ndërkombëtare <i>Vienna Congress and the Balkans 200 years later (1815-2015)</i> , Institute for Political and International Studies, Shkup, 2015.	2
1.5	Aurora Karameti. "Reporting environmental pollution: Media and public discourse vs. political discourse in the Republic of Macedonia". Konferencë ndërkombëtare <i>After Communism East and West under Scrutiny</i> , University of Craiova, Rumani, 2015.	3
1.6	Aurora Karameti. "National culture, multiculturalism and the Albanian media in Macedonia: modern global models and local issues". Konferencë ndërkombëtare <i>Communication and Media Studies</i> organizuar nga ESJ Paris, IPAG Business School Paris, Universiteti i Tiranës dhe Kolegji AAB, Prishtinë, 2015.	2
1.7	Aurora Karameti. "News media as a social factor for law enforcement in the Republic of Macedonia". Konferencë ndërkombëtare <i>Humanities and social sciences ICHSS 2014</i> , organizuar nga Mediterranean Center of Social and Educational Research, Rome-Itali dhe University of Montenegro, Budva, 2014.	3
1.8	Aurora Karameti. "Masmedia ne rolin e parapriresit te ndryshimeve shoqerore". Konferencë ndërkombëtare <i>Rule of Law and Democracy</i> , Universiteti i Tetovës, 2014.	2
1.9	Aurora Karameti. <i>The right and the political culture as a factor influencing the construction of the modern state</i> . Konferencë rajonale, Gjilan-Kosovë, 2014.	2
1.10	Aurora Karameti. "The contribution of US programs in the development of communication sciences as a new field of study in Macedonia". Seminar ndërkombëtar <i>The role of the United States in the development of higher education and democratisation of the society in Macedonia</i> , USHT, 2013.	2
2	Artikuj me Rezultate Shkencore Origjinale, të Publikuara në Revistë Referente Shkencore / Profesionale me Bord Redaktues Ndërkombëtar	
2.1	Aurora Karameti. "Le traitement médiatique et socio-politique de la question de migration transitoire en Macédoine". <i>Regards croisés sur la crise migratoire vue par des intellectuels des deux rives de la Méditerranée</i> , Vepër kolektive. Botues: Forum de Recherche sur les Médias en Méditerranée, 2017 (në proces botimi). Paris, Francë.	6
2.2	Aurora Karameti. "Reporting environmental pollution: Media and public discourse vs. political discourse in the Republic of Macedonia". <i>Revue des sciences politiques</i> (Revista de stiinte politice), Nr. 43, 2015, Craiova-Rumani.	6
2.3	Aurora Karameti. « Multiculturalism and the Albanian-speaking media in Macedonia : Modern global models and local issues ». <i>Thesis</i> . Nr. 2, 2015, fq. 67-78. KAAB, Prishtinë-Kosovë.	4

2.4	Aurora Karameti. “Geopolitical genesis of international public agenda as an impact of the Vienna Congress”. <i>Vienna Congress and the Balkans: 200 years later (1815-2015)</i> . Fq. 19-29. Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Ambasada e Austrisë, Shkup, 2015.	4
2.5	Aurora Karameti. “News media as a social factor for law enforcement in the Republic of Macedonia”. <i>Mediterranean Journal of Social Sciences</i> , Vol. 5, Nr. 13, 2014. MCSER Publishing, Romë-Itali.	6
2.6	Aurora Karameti dhe Aferdita Sokoli. “Roli i Televizionit <i>Alsat-M</i> si një medium dygjuhësor, për njohjen ndëretnike të audiencës në Maqedoni”. <i>International journal for social sciences Visione</i> , Nr. 22 (1) 2014. Fq. 767-772. Shkup.	6
2.7	Aurora Karameti. “Media në Maqedoni midis krijimit të opinionit dhe pasqyrimit të tij ». <i>JUSTICIA</i> , Vol.2, Nr.1, 2014, Tetove. ISSN 1857-8454	4
3	Anëtar i bordeve shkencore dhe komiteteve organizuese	
3.1	Kandidatja ka qenë anëtare e komitetit organizativ të punëtorisë <i>Civil society and contemporary security challenges</i> , organizuar nga Institute for political and international studies, 2015, në Shkup, Maqedoni.	1
3.2	Anëtare e komitetit organizativ të International Seminar <i>The role of the US in the development of higher education and democratization of the society in Macedonia</i> , organised by Association for American Studies in SEE and the Fulbright Association. Held in SUT, Tetovo - Macedonia, February 2013.	1
3.3	Kandidatja ka qenë anëtare e komitetit organizativ të International Conference <i>Euroregions: Integrating Societies-Generation Growth-Caring Resources</i> , organised by the Institute for political and international studies, September 2013, Struga-Macedonia.	1
3.4	Bashkë- organizatore e International Seminar “The role of the US in the development of higher education and democratization of the society in Macedonia”. Financuar nga Fulbright Association, 2013.	1
GJITHSEJ:		62

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1	Libra të botuar dhe recensione	
1.1	Monografi. <i>Media dhe gjeopolitika e një konflikti etnik</i> . 282 faqe, 2014. Universiteti Shtetëror I Tetoves.	10
1.2	Recension i librit : <i>Trileri i O.J. Schmitt për Kosovën</i> , i autorit Ibrahim Kelmendi. Buzuku & Epoka e Re, Prishtinë, Kosovë.	4
2	Pjesëmarje në projekte shkencore	
2.1	Erasmus+ 2016. Kandidatja ka marrë pjesë në projektin arsimor TEL4SL (Technology Enhanced Learning for Social Literacy), në Values University, në Mafra të Portugalisë.	5

2.2	Në vitin 2013 kandidatja është angazhuar si studiuese e medias nga MEDIAMORPHOSIS për shkrimin e artikujve kritikë mbi produksionin e medias në Maqedoni në kuadër të programit « Strengthening Media in Macedonia - Media Fact-Checking Service Component » financuar nga USAID.	3
2.3	Ka pjesëmarrje në punëtorinë rajonale “ <u>Equal Accesss through Service Learning for Persons with Disabilities</u> ”, organizuar nga Macedonian American Alumni Association, mbajtur në Universitetin Shën Kirili dhe Metodi në Shkup, 2013.	3
	GJITHSEJ:	25

VEPRIMTARI ME INTERES MË TË GJERË

Nr. rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
1	Veprimtari me interes më të gjerë	
1.1	Anëtare e Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga dhjetori i vitit 2013	1
1.2	Bashkëpunim, gjatë vitit 2015, me Aleancën Franceze në Tetovë për organizimin e aktiviteve në kuadër të projektit “Fonds d’Alember” në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës.	1
1.3	Në vitin 2016 ka pasur bashkëpunim me Institutin Francez në Shkup për botimin për herë të parë të broshurës “Témoignages Alumni” rreth mundësive për studime në Francë për nxënësit dhe studentët e Republikës së Maqedonisë, ku ka ofruar përvojën personale.	1
	GJITHSEJ :	3

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	153.2
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	62
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative	25
4.	Veprimtaria me interes me te gjere	3
	Gjithsej	243.2

Komisioni Recensues:

Prof. Dr. Ylber Sela, kryetar

Prof. Dr. Bashkim Gjergji, anëtar

Prof. Dr. Ferat Polisi, anëtar

Drejtuar:
**Këshillit të Rektoratit të
Universitetit të Tetovës**
Tetovë

R E F E R A T

për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët “E drejta sendore (reale)” dhe “E drejta familjare dhe trashëgimore” në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës

Në bazë të Konkursit për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës të datës 30.01.2018 të shpallur në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, “www.unite.edu.mk” dhe në gazetatat ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija” me datë 31.01.2018, për zgjedhje-rizgjedhje të një mësimdhënësi për lëndët: **“E drejta sendore (reale)” dhe “E drejta familjare dhe trashëgimore” në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës**, me Propozim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik Nr.13-178/3, të datës 20.02.2018 dhe me Vendim të Këshillit të Rektoratit nr. 02-1136/1 të dates 06.03.2018 formohet Komisioni recensues në përbërje:

1. Prof.dr. ABDULLA ALIU - Kryetar
2. Prof.dr. HAMDİ PODVORICA – anëtar
3. Prof.dr. MERSIM MAKSUTI anëtar

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenet 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsim të Lartë (Teksti i konsoliduar “Gazeta Zyrtare e RM-së” nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe thirrjet e bashkëpunëtorëve dhe asistent-doktorantëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor–Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N S I O N

Në konkursin e shpallur nga Universiteti i Tetovës me datë 30.01.2018 në web faqen www.unite.edu dhe në gazetatat ditore “Koha” dhe “Nova Makedonija”, për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: **1. “E drejta sendore (reale)” dhe 2. “E drejta familjare dhe trashëgimore”** në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, **u paraqit kandidati:**

1. Doc.Dr. Afet Mamuti

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Doc.dr. Afet Mamuti ka lindur më 12.11.1975 në fsh. Poroj të Tetovës. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje, kurse shkollimin e mesëm në Gjimnazin “Kiril Pejçinoviç”, drejtimi Matematik-natyror në Tetovë. Ka studiuar dhe diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, ku dhe fiton titullin Jurist i diplomuar.

Në vitin akademik 2005/06 ka regjistruar studimet posdiplomike të magjistraturës në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Departamentin e të Drejtës Civile. Studimet posdiplomike të magjistraturës i mbaron me notë mesatare të lëndëve 9.4, kurse me datë 27.09.2007 mbron tezën e magjistraturës, e cila vlerësohet me sukses të shkëlqyeshëm nga Juria Profesionale dhe i njëjti fiton titullin Magjistër i Shkencave Juridike Civile.

Kandidati Afet Mamuti në vitin 2009 regjistron studimet e doktoratës në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Departamentin e të Drejtës Civile. Në mbledhjen e Këshillit të Profesorëve të Fakultetit të Drejtësisë, kandidati i miratohet teza e doktoratës “Përgjegjësia juridike civile për shpërblimin e dëmit në Maqedoni” me udhëheqës shkencor Prof. Dr. Kudret Çela. Disertacionin e doktoraturës kandidati e mbron më 01.04.2013 pranë Jurisë për mbrojtjen e doktoraturës, e cila vlerësohet me sukses maksimal dhe kandidati fiton titullin shkencor **Doktor i Shkencave Juridike Civile**.

Kandidati Dr. Afet Mamuti në konkurs i dorëzoi këto dokumente:

1. Diplomën e Doktoratës (kopje të noterizuar);
2. Vendimin për zgjedhje rizgjedhje në Thirrjen mësimore-shkencore Docent (kopje të noterizuar);
3. Listën e punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara në revista shkencore dhe konferenca shkencore, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
4. Vërtetim për njohje të gjuhës së huaj;
5. Biografi të shkurtër (CV) nga e cila mund të konstatohen aktivitetet permanente shkencore dhe profesionale dhe konferenca të shumta të nivelit shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar;
6. Çertifikatë nga libri amzë i të lindurve;
7. Çertifikatë shtetësie;
8. Kopje të çertifikatave dhe mirënjohjeve tjera.

Përvoja universitare

Përvoja profesionale e kandidati Doc.dr. Afet Mamuti është siç vijon: Nga 1 tetori 2003 fillon punën si asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës për lëndët: 1. E drejta e detyrimeve dhe 2. E drejta familjare, me kontratën e evidentuar nr.02-550/1, datë 24.12.2003. Pas zyrtarizimit të Universitetit të Tetovës kandidati nga Komisioni amë për themelimin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, zgjedhet **Asistent i ri**, në marrëdhënie pune të rregullt në Fakultetin Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga data 17.07.2004, Vendimi i evidentuar me numër 23-2805/168, të datës 24.08.2004 në fushën e të drejtës. Më datë 22.03.2010 zgjedhet bashkëpunëtor në thirrjen **asistent**, në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, Vendimi numër 02-1760/1 të datës 19.04.2010, në lëndët “E drejta

romake” dhe “E drejta e detyrimeve”. Në vitin 2004 ka qenë i angazhuar si ligjërues për lëndët nga fusha e drejtësisë, në Qendrën për trajnimin e administratorëve për programin e BE-së, PACE I dhe PACE II në Shkup, i finansuar dhe mbështetur nga British Council, ku ka marrë dhe mirrënjohje. Në vitin 2005, gjithashtu ka qenë i angazhuar nga British Council – Shkup për ligjërues në Qendrën për pregaditjen e përkthyesve për në gjykata dhe në administratë shtetërore në Shkup, për lëndët nga fusha e drejtësisë. Pas hapjes së studimeve të disperzuara në Shkup dhe Kërçovë nga USHT-ja, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, kandidati ka qenë i angazhuar në këto qendra në lëndët mësimore: E drejta romake, E drejta familjare dhe trashëgimore dhe E drejta sendore. Në vitin 2013 zgjedhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**, Vendimi nr. 02-6885/1, në lëndët: “E drejta familjare dhe trashëgimore” dhe “E drejta reale (sendore)”, pozitë të cilën e ushtron në kontinuitet edhe aktualisht. Nga viti 2013 gjithashtu është i angazhuar edhe në studimet Master në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në lëndët: E drejta sendore, E drejta e detyrimeve, E drejta kontraktore ndërkombëtare, Marrëdhëniet kontraktore ndërkombëtare, Regjistrimi i drejtave të paluajtshmërive. Anëtarë i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, nga viti 2013. Përveç se në Maqedoni, kandidati është i angazhuar si Profesor edhe në rajon. Kështu në vitin akademik 2015/16 ka qenë i angazhuar në Universitetin publik “Kadri Zeka” në Gjilan në Fakultetin Juridik në lëndët E drejta familjare dhe trashëgimore, E drejta e kadastrave dhe Klinika juridike civile. Në vitet në vijim vazhdon angazhimin si Profesor në Prishtinë në Kolegjin ISPE, në lëndët: E Drejta e Pronësisë Intelektuale, E Drejta Europiane Kontraktore, E Drejta e Detyrimeve dhe E Drejta Ndërkombëtare Private.

Aktivitete profesionale dhe shkencore:

- Në vitin 1999, ka punuar në Organizatën joqeveritare Amerikane IMC (International Medical Corps).
- Nga 1 tetori 2003 fillon punën si asistent në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës për lëndët: 1. E drejta e detyrimeve dhe 2. E drejta familjare.
- Më 24.08.2004 – me Vendim të Komisionit amë për themelim të Universitetit Shtetëror të Tetovës, zgjedhet në thirrjen mësimore të bashkëpunëtorit -“asistent i ri për lëndën “E drejta romake”, të cilën lëndë pa ndërprerje vazhdon ta ligjëron edhe tani.
- Në vitin 2004 ka qenë i angazhuar si ligjërues për lëndët nga fusha e drejtësisë, në Qendrën për trajnimin e administratorëve për programin e BE-së, PACE I dhe PACE II në Shkup, i finansuar dhe mbështetur nga British Council, ku ka marrë dhe mirrënjohje.
- Në vitin 2005, gjithashtu ka qenë i angazhuar nga British Council – Shkup për ligjërues në Qendrën për pregaditjen e përkthyesve për në gjykata dhe në administratë shtetërore në Shkup, për lëndët nga fusha e drejtësisë.
- Ka qenë anëtar i Komisionit Komunal Zgjedhor në Tetovë, në zgjedhjet lokale për Kryetar dhe Këshillin e Komunës së Tetovës, 2005.
- Ka qenë nënkryetar i Komisionit për çështje të mandateve, zgjedhjeve dhe emërimeve në Këshillin e Komunës së Tetovës 2005-2009.

- Ka qenë Kryetar i Këshillit Drejtues të NATP“Polet”Tetovë, Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës, nr.3/2005, dt.24.06.2005
- Në vitin 2005, ka ndjekur Shkollën për gjuhën angleze në Oxford House College, Oxford, Angli.
- Më 14 nëntor të vitit 2006 nga Këshilli mësimor i Fakultetit Juridik zgjedhet Prodekan për çështje studentore.
- Më 25 gusht të vitit 2008 nga Kuvendi i Maqedonisë zgjedhet në detyrën e Zv/Sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit të RM-së, të cilën detyrë e ka ushtruar deri në vitin 2010.
- Nga 19-30 tetor të vitit 2008, mer pjesë në workshop-in e organizuar nga House Democracy Assistance Commission (HDAC), në Washington në ndërtesën e (Dhomës së Përfaqësuesve) Kongresit Amerikan.
- Me Vendimin nr.11-7563/1 të datës 10.10.2008 nga Mnistria e Arsimit zgjedhet Kryetar i Komisionit për dhënie të provimit profesional për mësimdhënës të lëndëve nga fusha e drejtësisë për shkollat e mesme publike.
- Në vitin 2010, në konkursin për zgjedhje – rizgjedhje të USHT-së, kandidati avansohet në thirrjen mësimore të asistentit për lëndët: 1. E Drejta Romake dhe 2. E Drejta e Detyrimeve.
- Ka qenë angazhuar si ekspert nga“European Patent Office”, me seli në Munich, Germany për ekspertizën për “Activity MK 2.5 Review of Trademark (TM) internal procedures and drafting of guidelines” – Contract no.8268.
- Nga 2 marsi i vitit 2011, zgjedhet Kryetar i Shoqatës së Juristëve të Maqedonisë, detyrë që e vazhdon edhe tani.
- Kandidati ka zhvilluar leksion të hapur me studentët e Degës së Drejtësisë dhe Shkencavë Shoqërore në Univeristetin “Pavarësia” Vlorë me dt.13.05.2011, të vërtetuar me Vërtetimin nga Rektorja Prof.dr. Arta Musaraj.
- Nga 14.02. 2011 me Vendimin nr.02-730/1 deri 2013 ka qenë Kordinator për ECTS pranë Fakultetit Juridik të USHT-së.
- Nga viti 2013 deri 2017 ka qenë anëtar i Komisionit për çështje statutare juridike në Komunën e Tetovës
- Me vendimin nr: 07-4283 datë 27.12.2013 të Ministrit të Drejtësisë, zgjedhet anëtar i Grupit punues për përgatitjen e tekstit të ri të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore të RM-së
- Në vitin 2014 ka qenë anëtarë i Komisionit për përgatitjen e pyetjeve për provim pranues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokuror publik në Maqedoni.
- Me datë 01.02.2018 nga Këshilli mësimor-shkencor caktohet për anëtar i Komisionit për verifikim të notave të studentëve të diplomuar në Fakultetin Juridik.
- Udhëheqës shkencor i më shumë studentëve në master dhe anëtarë dhe Kryetar i disa Komisioneve për mbrojtje të Masterit.

- Kandidati me Vendim të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Juridik është zgjedhur Koordinator i Qendrës për Pronësi Industriale në kuadër të Fakultetit. Vendimi nr.13-696/1, datë: 14.12.2015
- Anëtar i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "JUSTICIA" të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, që nga themelimi
- Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "ULPIANUS" të Shoqatës së Juristëve Shqiptar në Maqedoni
- Anëtar i këshillit organizativ në Konferencën Ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE” të organizuar nga Fakulteti Juridik – Univeristeti i Tetovës, me datë 18-19 nëntor 2016
- Anëtar i komitetit organizativ të “4th International Scientific Conference - Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” date 17-18 November 2017 University of Tetova, Tetova, Macedonia
- Më 2014 gjatë pushimeve të verës kandidati ka ndjekur shkollën verore “Zoni Language Centers”, në Manhattan, New York dhe Teaching House në New York, SHBA.
- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti më 24 shtator 2017 është shpallur Ambasador për Paqë nga Universal Peace Federation, në Konferencën e Lidershit European të organizuar në Prishtinë.
- Kandidati ka marrë pjesë në pregatitjen e studentëve të Fakultetit Juridik, për pjesëmarrje në garat e organizuara me temën “Ditët e gjyqimit të simuluar” të mbajtura në Shtip më 2016 dhe 2017 nga Misioni i OSBE-së – Shkup
- Anëtar i “Klubit debates” pranë Fakultetit Juridik, në promovimin e të cilit ka mbajtur dhe ligjëratën “Roli i shtetit dhe familjes në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, dt.02.05.2017
- Pjesëmarrës - panelist në debatin e organizuar nga Fakulteti Juridik, në lidhje me ndryshimet Kushtetuese të propozuara nga Qeveria, datë 23.09.2014
- Pjesëmarrës- panelist në debatin e organizuar nga Fakulteti Juridik në lidhje me ndryshimet në Ligjin për arsim sipëror në RM, datë 19.12.2014.
- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare të VI të alb-shkencës, 2011, Prishtinë me temën “Marrëdhënia juridike e adoptimit dhe efektet e tij në funksion të interesit më të lartë të fëmijës”.
- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën e VI shkencore ndërkombëtare të alb-shkencës, 2011, Prishtinë me temën “Procedurat e identifikimit dhe regjistrimit të konfliktit të interesit të nëpunësit civil gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare në shërbimin civil”.
- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën e VII-të shkencore ndërkombëtare të alb-shkencës, 2012, Shkup “Përgjegjësia civile e personit juridik për dëmin e shkaktuar ndaj personave të tretë”,
- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti ka marrë pjesë në Konferencën shkencore të organizuar nga Departamenti Civil i Fakultetit të Drejtësisë të UT-së me rastin e 100 vjetorit të shtetit shqiptar

për tematikën “Private law in 100 years of Albanian State” me temën e prezentuar Marrëdhëniet juridike familjare në Kosovë në këndvështrimin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë”, 10 December 2012

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore Ndërkombëtare “The integration of the southeastern Europe in the European Union – Challenges” ,Tetovë, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT-së 29-30qershor 2013.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare „SHTETI JURIDIK DHE DEMOKRACIA” Tetovë 12.03.2014, me temën “*Aspektet civile juridike për mbrojtjen nga dhuna në familje*”

- Pjesëmarrës në “20th International Research Conference on Business, Economics and Social Sciences”, IRC-2015, *December 05-06, 2015, Istanbul, Turkey*.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare me temën “To no one will we sell, to no one deny or delay right or justice” – the legacy of Magna Carta 1215 for the Western Balkans, me temën “The right to a Fair Trial, The Comparative Aspect of Macedonia – Strasburg Court, 17 June 2015.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në Konferencën shkencore ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE” datë 18-19 nëntor 2016, me temën “Testamenti – të provuarit dhe vlefshmëria e tij sipas legjislacionit të Maqedonisë”, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në 4th International Scientific Conference “Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” Date: 17-18 November 2017 University of Tetova, me temën “The role of State Institutions for Prevention and Protection from Domestic Violence” Tetova, Macedonia

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në International scientific conference “After Communism. East and West Under Scrutiny” 8-9 April 2016, Craiova, Romania, me temën “The New Reproductive Technology and Parent-Child Relationship”.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në emisionit e Televizionit nacional Tv Art, në temën “Koncepti i martesës dhe i shkurorëzimit”, më 23 Janar 2017.

- Kandidati Doc.dr. Afet Mamuti, ka marrë pjesë në “Knowledge in practice XV-th Jubilee, International Scientific Conference”, 15-17 December 2017, Bansko Bulgaria, me temën “Acquisitions of Property by Foreigners”, published on Vol.20

Publikimet në revista shkencore dhe konferenca shkencore:

- Doc.Dr. Afet MAMUTI “Protection of Ownership Rights under The Legislation of Macedonia”, Revista ndërkombëtare për shkenca shoqërore – “Vizione”, nr.29 Janar 2018 Shkup. ISSN: 1409-8962- printed form, ISSN 1857- 9221- electronic form. Botues: Shoqata e Intelektualëve “Klubi Demokratik” – Shkup

- Doc.Dr. Afet MAMUTI, “Меѓународна и национална правна заштита на правата на децата”, “Зборник”-Правен Факултет Јустиниан Први Скопје, Januar 2018, Скопје.

- Doc.Dr. Afet MAMUTI, “Acquisition of property by foreigners”, Fifteenth International Scientific Conference KNOWLEDGE IN PRACTICE , December, 2017, Bansko, Bulgaria, Global Impact Factor GIF 1.322 (2016), ISSN 1857-92

- Doc.Dr. Afet MAMUTI, “The Role Of The State And Family In Implementing The Principle Of Special Protection Of Children”, Revista ndërkombëtare për shkenca shoqërore – “Vizione”, nr.28, ISSN: 1409-8962- printed form, ISSN 1857- 9221- electronic form, Botues: Shoqata e Intelektualëve “Klubi Demokratik” – Shkup

- Doc.Dr. Afet MAMUTI, "The New Reproductive Technology and Parent-Child Relationship", Revista de Stiinte Politice, University Of Craiova Faculty Of Social Sciences Political Sciences Specialization & Center Of Post-Communist political Studies (Cepos). Revue des Sciences Politiques, RSP • No. 51 • 2016: 165-173 ISSN: 1584-224X,
- Doc.Dr.Afet MAMUTI, "Koncepti juridik për mbrojtjen nga dhuna në familje", Revista shkencore ndërkombëtare "JUSTICIA" ISSN 1857-8454, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nr.3/20, Botime nga Konferenca shkencore ndërkombëtare "Universalizmi, Globalizimi dhe Shteti i së Drejtës", Mars, 2014.
- Doc. Dr. Afet MAMUTI, "Përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga institucionet mjekësore dhe punëtorët mjekësor", Revista shkencore ndërkombëtare "Justicia", Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2013. Borime nga Konferenca shkencore ndërkombëtare. ISSN: 1857-8454
- Afet Mamuti, "Aspektet procedurale dhe sfidat e adoptimit sipas legjislacionit të Maqedonisë", "Ulpianus" - Revistë shkencore dhe profesionale për drejtësi, Shoqata e juristëve shqipëtarë të Maqedonisë, 2013. ISSN: 1857-8144
- Doc.dr. Afet Mamuti, "Marrëdhëniet juridike familjare në Kosovë në këndvështrimin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë". Libri i botimeve nga Konferenca shkencore ndërkombëtare me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, 10 dhjetor 2012, Tiranë.
- Afet MAMUTI, "Përgjegjësia civile nga dëmi i shkaktuar prej shpifjes", "Studime Juridike", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2012.
- Afet MAMUTI, "Aspekte të përgjegjësisë juridike civile për shpërblimin e dëmit", "Studime Juridike", Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, 2010, Vëllimi 2.
- Afet MAMUTI, "Trajtim mbi aspektet e veçanta të shpërblimit të dëmit jomaterial në doktrinën juridike dhe në praktikën gjyqësore", "Ulpianus"-Revistë shkencore dhe profesionale për drejtësi, Shoqata e juristëve shqipëtarë të Maqedonisë, 2012.
- A.Nuhui & A. Mamuti, Стандардизација на прописите со кои е регулирано прашањето за наследување на правата од индустриската сопственост во РМ, Forumi Shkencor për Pronësi Industriale, Shkup, 2010. ISBN 978-608-4628-06-4
- Julejda Gërxi & Afet MAMUTI, The policies of identifying and managing conflicts of interest of civil servants in the civil servis, "academicus", International Scientific Journal, Vlorë, MMXI (2011), edicioni III. ISSN 2079-3715
- A.Nuhui & S.Emruli & A. MAMUTI, "Marrëveshja e stabilizim-asociimit, Maqedonia dhe Shqipëria drejt BE-së", Legjislacioni dhe drejtësia shqiptare përballë sfidave të integritetit në BE Revistë Shkencore "Justiniani I", Botim i Universitetit Justiniani i I-rë, 21 maj 2010, vëllimi 2.
- Afet Mamuti, "Përgjegjësia juridike civile dhe baza e saj", Përmbledhje e punimeve shkencore nga konferenca ndërkombëtare shkencore juridike, Tetovë, UT, 2008
- Afet Mamuti, "Marrëdhënia juridike e adoptimit dhe efektet e tij në funksion të interesit më të lartë të fëmijës", Publikim nga Konferenca ndërkombëtare e VI e alb-shkencës, 2011, Prishtinë. ISBN 978-9951-518-10-9
- Afet Mamuti, "Procedurat e identifikimit dhe regjistrimit të konfliktit të interesit të nëpunësit civil gjatë ushtrimit të funksioneve zyrtare në shërbimin civil", Përmbledhje punimesh nga Konferenca ndërkombëtare e VI e alb-shkencës, 2011, Prishtinë. ISBN 978-9951-518-10-9
- Afet Mamuti, "Përgjegjësia civile e personit juridik për dëmin e shkaktuar ndaj personave të tretë", Përmbledhje punimesh nga Konferenca ndërkombëtare e VII e alb-shkencës, 2012, Shkup, ISBN 978-608-65463-0-4

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të analizës të aktiviteteve të lartëpërmendura të kandidatit dhe në bazë të përvojës së vazhdueshme profesionale, akademike dhe pedagogjike, Komisioni recensues vlerëson se kandidati Doc.dr. Afet Mamuti i plotëson të gjitha kushtet ligjore për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

Duke marrë parasysh aktivitetin gjithpërfshirës të kandidatit nga sfera e të drejtës, si dhe kontinuitetin mbi pesëmbëdhjetëvjeçar në studimet për fushën civile gjatë marrjes të të gjitha gradave shkencore dhe atyre mësimore deri tek Docenti e më pas, pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, projekte hulumtuese, të arriturat shkencore të prezantuara në disertacionin e doktoraturës, punimin e magjistraturës, punimet shkencore dhe profesionale të publikuara, lojalitetin ndaj Universitetit që nga themelimi i tij si student i gjeneratës së parë dhe si njëri ndër asistentët e parë, attribute që janë në përputhje dhe me vizionin e Universitetit për krijimin e kuadrove profesionale, kompatibilitetin profesional me lëndët e shpallura në konkurs, vlerësimet maksimale nga studentët gjatë procesit të evaluimit dhe aktivitetet tjera me natyrë profesionale, Komisioni recensues vlerëson se **Doc. dr. Afet MAMUTI** i plotëson të gjitha kushtet për avancimin në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë të RM-së, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin t'i propozon Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doc. dr. Afet Mamuti** të zgjedhet Profesor për lëndët: **“E drejta sendore (reale)”** dhe **“E drejta familjare dhe trashëgimore”** në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

KOMISIONIRECENZUES:

1. Prof. Dr. Abdulla Aliu, kryetar

2. Prof. Dr. Hamdi Podvorica, anëtar

3. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar

SHTOJCË

**PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE
DHE MËSIMORE-PROFESIONALE**

Kandidati: **Doc. Dr. Afet Mamuti**

Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**

Programi studimor: **Studime të Drejtësisë**

VEPRIMTARIA MËSIMORE ARSIMORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Mbajtja e Ligjeratave	
I.1	E Drejta Romake (2+1, Tetovë, 4 semestra)	2x15x4x0.04=4.8
I.2	E Drejta Romake (2+1, Shkup, 3 semestra)	2x15x3x0.04=3.6
I.3	E Drejta Familjare dhe Trashëgimore (3+1, Tetovë, 4 semestra)	3x15x4x0.04=7.2
I.4	E Drejta Familjare dhe Trashëgimore (3+1, Shkup, 2 semestra)	3x15x2x0.04=3.6
I.5	E Drejta Familjare dhe Trashëgimore(3+1, Kërçovë, 3 semestr)	3x15x2x0.04=3.6
I.6	E Drejta Sendore (2+1, Tetovë, 4 semestra)	2x15x4x0.04=4.8
I.7	E Drejta Sendore (2+1, Kërçovë, 3 semestra)	2x15x3x0.04=3.6
I.8	E Drejta Transportuese në Komunikacion (3+1, Tetovë, 2 semestra)	3x15x2x0.04=3.6
I.9	E Drejta Familjare dhe Trashëgimore (2+1, 2 grupe, Gjilan, 1 semestër)	2x15x2x0.04=2.4
I.10	E Drejta e Kadastrave (2+1, Gjilan, 1 semestër)	2x15x1x0.04=1.2
I.11	Klinika Juridike Civile (2+1, Gjilan, 1 semestër)	2x15x1x0.04=1.2
I.12	E Drejta Europiane Kontraktore (2+1, Prishtinë, 2 semestra)	2x15x2x0.04=2.4
I.13	E Drejta e Detyrimeve (2+2, Prishtinë, 2 semestra)	2x15x2x0.04=2.4
I.14	E Drejta Ndërkombëtare Private (2+1, Prishtinë, 2 semestra)	2x15x2x0.04=2.4
I.15	E Drejta e Pronësisë Intelektuale (2+1, Prishtinë, 2 semestra)	2x15x2x0.04=2.4
I.16	E drejta e Regjistrimit të Paluajtshmërive (Drejtimi Gjyqësor, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
I.17	E drejta e Regjistrimit të Paluajtshmërive (Drejtimi Civil, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
I.18	E Drejta Kontraktore (Drejtimi Gjyqësor, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
I.19	E Drejta Kontaktore Ndërkombëtare (Drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
I.20	Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare (Drejtimi E Drejta Ndërkombëtare dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
I.21	E Drejta e Detyrimeve (Drejtimi Civil, Cikli Master, 2+1, semestër)	2x15x1x0.05=1.5
I.22	E Drejta Sendore (Drejtimi Civil, Cikli Master, 2+1, 2 semestra)	2x15x2x0.05=3
II	Mbajtja e Konsultimeve	
II.1	E Drejta Romake (2+1, Tetovë, 4 semestra)	60x4x0.002=0.48
II.2	E Drejta Romake (2+1, Shkup, 3 semestra)	70x3x0.002=0.42

II.3	E Drejta Familjare dhe Trashëgimore (3+1, 4 semestra)	110x4x0.002=0.88
II.4	E Drejra Familjare dhe Trashëgimore (3+1, Shkup, 2 semestra)	100x2x0.002=0.4
II.5	E drejta sendore (2+1, Tetovë, 4 semestra)	120x4x0.002=0.96
II.6	E Drejta sendore (2+1, Kërçovë, 3 semestra)	40x3x0.002=0.24
III	Mentor i Punimeve të Masterit	
	Mentorim i punimeve të Masterit	10x2=20
IV	Anëtarë dhe Kryetar në Komisione për Mbrojtjen e Punimeve të Masterit	
	Anëtarë në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të Masterit	22x1=22
	Gjithësej:	114.08

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Pjesëmarje në Projekte Shkencore	
I.1	Me vendimin nr: 07-4283 datë 27.12.2013 të Ministrit të Drejtësis, zgjedhet anëtar i Grupit të ekspertëve për pregatitjen e tekstit të ri të Ligjit për pronësi dhe të drejta tjera sendore të RM-së	2
I.2	Nga zyra “European Patent Office” ka qenë angazhuar si ekspert, me seli në Munich, Germany për ekspertizën për “Activity MK 2.5 Review of Trademark (TM) internal procedures and drafting of guidelines” – Contract no.8268	3
I.3	Në vitin 2014 ka qenë anëtarë i Komisionit për pregatitjen e pyetjeve për provim pranues në Akademinë për Gjykatës dhe Prokuror publik në Maqedoni	2
II	Artikuj me Rezultate Shkencore Origjinale, të Publikuara në Revistë Referente Shkencore / Profesionale me Bord Redaktues Ndërkombëtar	
II.1	“The New Reproductive Technology and Parent-Child Relationship”, University Of Craiova Faculty Of Social Sciences Political Sciences Specialization & Center Of Post-Communist political Studies (Cepos). Revue des Sciences Politiques, RSP • No. 51 • 2016: 165-173 ISSN: 1584-224X,	6
II.2	“The Role Of The State And Family In Implementing The Principle Of Special Protection Of Children”, Revista ndërkombëtare për shkenca shoqërore – “Vizione”, nr.28, ISSN: 1409-8962- printed form, ISSN 1857-9221- electronic form, Botues: Shoqata e Intelektualëve “Klubi Demokratik” – Shkup	6
II.3	“Acquisition of property by foreigners”, Fifteenth International Scientific Conference KNOWLEDGE IN PRACTICE –Botim, December, 2017, Bansko, Bulgaria, Global Impact Factor GIF 1.322 (2016), ISSN 1857-92	6
II.4	“Protection of Ownership Rights under The Legislation of Macedonia”, Revista ndërkombëtare për shkenca shoqërore – “Vizione”, nr.29 Janar 2018 Shkup. ISSN: 1409-8962- printed form, ISSN 1857- 9221- electronic form. Botues: Shoqata e Intelektualëve “Klubi Demokratik” – Shkup	6

II.5	“Меѓународна и национална правна заштita на правата на децата”, “Зборник”-Правен Факултет Јустиниан Први Скопје, Januar 2018, Скопје. EBSCO	6
II.6	“Koncepti juridik për mbrojtjen nga dhuna në familje”, Revista shkencore ndërkombëtare “JUSTICIA” ISSN 1857-8454, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nr.3/20, Botime nga Konferenca shkencore ndërkombëtare “Universalizmi, Globalizimi dhe Shteti i së Drejtës”, Mars, 2014	6
II.7	“Përgjegjësia juridike civile për dëmin e shkaktuar nga institucionet mjekësore dhe punëtorët mjekësor”, Revista shkencore ndërkombëtare “Justicia”, Fakulteti Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, 2013. Borime nga Konferenca shkencore ndërkombëtare organizuar nga Fakulteti juridik USHT. ISSN: 1857-8454	6
II.8	“Aspektet procedurale dhe sfidat e adoptimit sipas legjislacionit të Maqedonisë”, “Ulpianus” - Revistë shkencore dhe profesionale ndërkombëtare për drejtësi, Shoqata e juristëve shqiptar të Maqedonisë, 2013. ISSN: 1857-8144	6

III	Abstrakte të botuara në librin e abstrakteve nga konferencat shkencore ndërkombëtare	
III.1	“Testamenti – të provuarit dhe vlefshmëria e tij sipas legjislacionit të Maqedonisë” – Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Drejtësia dhe Sfidat e Proceseve Euroatlantike, organizuar nga Fakulteti Juridik, USHT 18-19 Nëntor 2016, Tetovë. ISBN 978-608-217-048-0	2
III.2	The doctrinal and normative parent-child relationship viewpoint of artificial impregnation, Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Universality, Globalization and the rule of Law”, 13-14 Nëntor 2015, Tetovë	2
	GJITHËSEJ:	60

VEPRIMTARIA PROFESIONALE-APLIKATIVE DHE VEPRIMTARIA ME INTERES TË GJËRË

Nr. Rendor	Emri i Aktivitetit	Pikët
1	Kordinator i Qendrës për Pronësi Industriale në kuadër të Fakultetit Juridik. Vendimi i Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Juridik nr.13-696/1, datë: 14.12.2015	2
2	Kryetar i Shoqatës së Juristëve Shqiptar në Maqedoni, nga 2 mars 2011, detyrë e ushtron dhe tani	3
3	Kryetar i Komisionit Disiplinor pranë Fakultetit Juridik nga data 07.07.2014, detyrë që e ushtron edhe tani.	2
4	Anëtar i “Klubit debatues” pranë Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, në promovimin e të cilit ka mbajtur dhe ligjëratën “Roli i shtetit dhe familjes në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”, dt.02.05.2017.	1

	Vendimi nr.13-1724/1 datë: 30.12.2016	
5	Anëtarë i Komisionit për verifikimin e notave të studentëve të diplomuar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Shtetëror të Tetovës, nga data 01.02.2018.	1
6	Ambasador për Paqë nga Universal Peace Federation, në Konferencën e Liderimit Europian të organizuar në Prishtinë	3
7	Kordinator i grupit për hartimin e Programit për caktimin e Departamenteve në kuadër të Fakultetit Juridik, shkurt 2014	2
8	Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "JUSTICIA" të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga data 03.09.2012	1
9	Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "ULPIANUS" të Shoqatës së Juristëve Shqiptar në Maqedoni, që nga themelimi	1
10	Anëtar i këshillit organizativ në Konferencën Ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE” të organizuar nga Fakulteti Juridik – Univeristeti i Tetovës, me datë 18-19 nëntor 2016	2
11	Anëtar i komitetit organizativ të “4th International Scientific Conference - Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” date 17-18 November 2017 University of Tetova, Tetova, Macedonia	2
12	Pjesëmarrje në “Knowledge in practice XV-th Jubilee, International Scientific Conference”, 15-17 December 2017, Bansko Bulgaria, me temën “Acquisitions of Property by Foreigners”, published on Vol.20	2
13	Anëtarë i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga dhjetori i vitit 2013	1
14	Nga viti 2013 deri 2017 anëtar i Komisionit për çështje statutare juridike në Komunën e Tetovës	2
15	Më 2014 gjatë pushimeve të verës kandidati ka ndjekur shkollën verore “Zoni Language Centers”, në Manhattan, New York dhe Teaching House në New York, SHBA	2
16	Profesor për pregatitjen e studentëve të Fakultetit Juridik, për pjesëmarrje në garat e organizuara me temën “Ditët e gjyqimit të simuluar” të mbajtura në Shtip më 2016 dhe 2017 nga Misioni i OSBE-së – Shkup	2
17	Anëtar i Komisionit për zgjedhje në thirrje mësimore	1
18	Pjesëmarrës - panelist në debatin e organizuar nga Fakulteti Juridik, në lidhje me ndryshimet Kushtetuese dhe amendamentet e propozuara nga Qeveria, datë 23.09.2014	2
19	Pjesëmarrës- panelist në debatin e organizuar nga Fakulteti Juridik në lidhje me ndryshimet në Ligjin për arsim sipëror në RM, datë 19.12.2014	2

20	Ditët e hapura USHT, prezantim i programeve studimore në kuadër të Fakultetit Juridik, viti 2016	1
21	Pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare “The integration of the southeastern Europe in the European Union – Challenges” ,Tetovë, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT-së 29-30qershor 2013.	2
22	Pjesëmarrës në International scientific conference “After Communism. East and West Under Scrutiny” 8-9 April 2016, Craiova, Romania, me temën “The New Reproductive Technology and Parent-Child Relationship”.	2
23	Pjesëmarrës në Konferencën shkencore ndërkombëtare „SHTETI JURIDIK DHE DEMOKRACIA” Tetovë 12.03.2014, me temën “Aspektet civile juridike për mbrojtjen nga dhuna në familje”	2
24	Pjesëmarrës në Konferencën Ndërkombëtare “DREJTËSIA DHE SFIDAT E PROCESEVE EUROATLANTIKE” datë 18-19 nëntor 2016, me temën “Testamenti – të provuarit dhe vlefshmëria e tij sipas legjislacionit të Maqedonisë”, organizuar nga Fakulteti Juridik USHT.	2
25	Pjesëmarrës në 4th International Scientific Conference “Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantic Integration Process” Date: 17-18 November 2017 University of Tetova, me temën “The role of State Institutions for Prevention and Protection from Domestic Violence” Tetova, Macedonia	2
	GJITHËSEJ:	45

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-arsimore	114.08
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	60
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative dhe veprimtaria me interes të gjërë	45
	Gjithësej	219.08

Komisioni Recensues:

1. Prof. Dr. Abdulla Aliu, kryetar

2. Prof. Dr.Hamdi Podvorica, anëtarë

3. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtarë

Drejtuar:
**Këshillit të Rektoratit të
Universitetit të Tetovës**
Tetovë

R E F E R A T

për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët „Teoria dhe praktika parlamentare“, „E drejta administrative“ dhe „E drejta kushtetuese krahasuese“ në Fakultetin Juridik - Universiteti i Tetovës

Në lidhje me konkursin për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore, profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, të datës 30.01.2018, të shpallur në gazetatat përkatëse: "Koha", "Нова Македонија" dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës, "www.unite.edu.mk", për zgjedhjen-rizgjedhjen e një mësimdhënësi në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar** për lëndët: **"Teoria dhe praktika parlamentare", "E drejta administrative" dhe "E drejta kushtetuese krahasuese"**, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, me Propozim të Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik nr.13-178/3 të datës 20.02.2018 dhe me Vendim të Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës nr.02-1136/1 të datës 06.03.2018, formohet Komisioni recensues në përbërje:

- 1. Prof. Dr. Arsim Bajrami, kryetar**
- 2. Prof. Dr. Mersim Maksuti, anëtar**
- 3. Prof. Dr. Fatmire Lumani, anëtar**

Komisioni recensues, pas shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar në lidhje me konkursin e lartpërmendur, dhe në përputhje me nenin 121, 124, 125, 131 dhe 132 të Ligjit për Arsim të Lartë (Teksti i konsoliduar "Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 35/08; 103/08; 26/09; 83/09; 99/09; 115/10; 17/11; 51/11; 123/12; 15/13; 24/13; 41/14; 116/14; 130/14; 10/15; 20/15; 98/15; 145/15; 154/15 dhe 30/16), Statutin e Universitetit të Tetovës, si dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës, i paraqet Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës këtë:

R E C E N S I O N

Në konkursin e datës 30.01.2018, të shpallur në gazetatat përkatëse: "Koha", "Нова Македонија" dhe në web faqen zyrtare të Universitetit të Tetovës: "www.unite.edu.mk", për zgjedhjen e një mësimdhënësi për lëndët: **"Teoria dhe praktika parlamentare", "E drejta administrative" dhe "E drejta kushtetuese krahasuese"**, në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës, ka konkurruar kandidati i vetëm: **Doc.dr.Jusuf Zejneli**.

1. Doc.dr.Jusuf Zejneli - të dhënat biografike

Në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kandidati Doc.dr.Jusuf Zejneli ka lindur më 28.04.1977 në Poroj, Komuna e Tetovës. Shkollimin fillor e ka kryer në vendlindje ndërsa shkollën e mesme në Tetovë. Në vitin 1996 u regjistrua në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, ku në mars të vitit 2001 i mbaroi studimet dhe e morri titullin Jurist i Diplomuar. Pas përfundimit të studimeve universitare të drejtësisë, kandidati po të njëjtin vit i filloi studimet e

Magjistraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, në drejtimin kushtetues-administrativ. Kandidati më 15 prill 2006 e mbrojti temën e magjistraturës me titull: “*Ndërtimi i shtetit ligjor me theks të veçantë në IRJM*” në mentorimin e Prof.Dr.Arsim Bajrami. Pas kryerjes së ciklit të dytë të studimeve (magjistraturës), kandidati regjistron studimet e doktoraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës në drejtimin kushtetues-administrativ, në udhëheqjen e mentorit Prof. Dr. Arsim Bajrami. Më 05 janar 2013 kandidati Jusuf Zejneli publikisht mbron me sukses disertacionin e doktoraturës me titull: “*Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë*”, dhe arrin thirrjen shkencore **Doktor i Shkencave Juridike**.

Kandidati Doc.dr.Jusuf Zejneli, i dorëzoi këto dokumente: Diplomë të noterizuar dhe Vendim për nostrifikim të diplomës për kryerjen e studimeve të ciklit të tretë, doktoraturës, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës; Diplomë të noterizuar dhe Vendim për nostrifikim të diplomës për kryerjen e studimeve të ciklit të dytë, magjistraturës, në Fakultetin Juridik në drejtimin kushtetues-administrativ në Universitetin e Prishtinës; Diplomë të noterizuar për kryerjen e Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës; Vërtetim për njohjen e gjuhës angleze, listë dhe kopje të punimeve shkencore, biografi nga e cila mund të konstatohen aktivitetet permanente në organizime, seminare dhe konferenca të shumta të nivelit shtetëror, rajonal dhe ndërkombëtar.

Përvoja universitare

Përvoja profesionale e kandidatit Dr. sc. Jusuf Zejneli është siç vijon: **Asistent i ri**, në marrëdhënie pune të rregullt në Fakultetin Juridik, Universiteti Shtetëror i Tetovës, nga data 17.07.2004, vendimi numër 23-2805/169, të datës 24.08.2004. Më datë 22.03.2010 zgjidhet bashkëpunëtor në thirrjen **asistent**, në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, vendimi numër 02-1755/1 të datës 19.04.2010. Në procesin mësimor, në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës dhe në studimet e disperzuara në Shkup, realizon angazhimin në lëndët mësimore: Teoria dhe praktika parlamentare, e drejta administrative, bazat e sistemit gjyqësor, e drejta kushtetuese, qeverisja lokale, gjithashtu ka zhvilluar mësim edhe në lëndët: demokracia parlamentare, sistemet politike, sociologjia e së drejtës, e drejta e procedurës administrative, sistemi amerikan i qeverisjes. Në vitin 2013 zgjidhet në thirrjen mësimore-shkencore **Docent**, Vendimi nr. 04-6904/1, në lëndët: “Teoria dhe praktika parlamentare” dhe “E drejta administrative“, pozitë të cilën e ushtron edhe aktualisht. Nga viti 2013 gjithashtu është i angazhuar edhe në studimet Master dhe atë të Doktoraturës në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në lëndët: E drejta administrative, Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë, Përgjegjësitë në administratën publike, Administratë publike e krahasuar dhe E drejta e procedurës administrative. Anëtar i Këshillit Mësimor Arsimor të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, do të jetë nga viti 2013.

Përvoja Profesionale

Praktikant në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë gjatë periudhës kohore 1999-2000, nga International Democratic Institute - Instituti Nacional Demokratik (NDI) dhe Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Kryetar i Unionit të Studentëve të Universitetit të Tetovës, 1998-2001. Prodekan për çështje mësimore i Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, nga shtatori i vitit 2007- korrik 2009. Disa herë anëtarë i Komisionit për transfer të studentëve

dhe anëtar i Komisionit për verifikimin e dokumenteve të administratës të Fakultetit Juridik me të cilët vërtetohet diplomimi i studentit. Nga data 31 tetor 2011, përsëri emërohet ushtrues i detyrës Prodekan për arsim i Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Nga qershori i vitit 2012 zgjidhet anëtarë i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare në Prishtinë, Republika e Kosovës. Udhëheqës shkencor - Mentor i më shumë se tetë kandidatëve në studimet Master në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës dhe anëtar komisioni në më shumë se 15 kandidatë. Anëtarë i Editorial Board të Revistës Ndërkombëtare - Shkencore Juridike (International Journal of Legal Sciences) "JUSTICIA" të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, nga data 03.09.2012. Anëtarë i Komisionit për evaluim në kuadër të Fakultetit Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, nga data 06.03.2014 deri më 12.11.2015. Koordinator për shkencë i Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, Vendimi nr. 02-2298/1 të datës 03.04.2014 deri më datë 10.03.2015. Realizues i Korrekturës të librit "Sociologjia e së Drejtës", të autorëve Prof.dr.Ferat Polisi dhe Doc.dr.Ali Musliu, botuar nga Vatra, Shkup 2015. Redaktor shkencor i librit: "Sistemet e Sigurisë" - "Sistema Security", të bashkautorëve: Bashkim Selmani & Mevludin Mustafi, botues, Furkan, Shkup 2016. Anëtarë i Redaksisë - Editorial Staff, të Revistës "JURIDICA", Revistë për studime juridike dhe shoqërore, magazine for legal and social studies, nga numri i pestë, botuar në vitin 2016, botues Kolegji Evropian Juridica në Prishtinë. Ligjërues - trajnues në Qendrën e Provimeve Shtetërore në Shkup, për përgatitjen e kandidatëve për provimin për drejtorë të shkollave fillore dhe të mesme, në modulën Legjislacioni, nga shtatori i vitit 2016. Trajnimi përfshin periudhën dyvjeçare, 2016-2018. Recensent i Librit Universitar të autorit Prof.dr.Kadri Kryeziu, të titulluar: "ABC-ja e së Drejtës dhe Shtetit". Botues i librit: Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Prizren 2016. Anëtar i grupit punues për përgatitjen e Propozim-ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, me Vendim të Ministrit të Drejtësisë në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, Vendimi nr. 23-2413/1, të datës 01.08.2017. Recensentë i librit: "Rregullativa dhe Parregullsitë Zgjedhore në Republikën e Maqedonisë", Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, të autorit Subhi Jakupi, Shkup 2017. Recensent i librit "Territori i Luftës së Heshtur, Trende dhe Dinamika të Reja Gjeopolitike në Evropën Juglindore", të autorit Selim Ibraimi, Tetovë 2018.

Aktivitetet shkencore dhe profesionale

Kandidati Doc.dr.Jusuf Zejneli, ka marrë pjesë në këto projekte shkencore dhe profesionale: 14.11.2008, *"Gjykimi në afatin e arsyeshem"*, organizuar nga Ministria e Drejtësisë në Republikën e Maqedonisë, mbajtur në Shkup, në selinë e Gjykatës Supreme. 18.12.2008, *"Односите меѓу Законодавната, Извршната и Судската власт"*, Organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve e Republikës së Maqedonisë. 06.10.2009, *"Vlerësim i Kushtetutshmërisë së Ligjit për Përcaktimin e Kushtit Plotësues për Kryerjen e Funksionit Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 14/08), në tërësi dhe në veçanti neni 5 paragrafi 1 pika 7, në pjesën: "Kryetarit të Republikës së Maqedonisë"*, organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, mbajtur në sallën e seancave të kësaj gjykate. 14.10.2009, *"Arsyeshmëria e Miratimit të Ligjit për Përcaktimin e Kushtit Plotësues për Kryerjen e Funksionit Publik"*, organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit Shtetëror të Tetovës, mbajtur në amfiteatrin e USHT-së. 02.12.2009, *"Statusi i Studentëve në Fakultetin Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës"*, organizuar nga Klubi studentor "Juristët e Rinj" të Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, në bashkëpunim me Qendrën për Shërbime Studentore dhe Karrierë në USHT. 09.12.2009, *"Liritë dhe të Drejtat e Njeriut si Kusht"*

Themelor të Shtetit Ligjor, Zhvillimit të Demokracisë dhe Progresit në Proceset e Integritimeve Euro- Atlantike", organizuar nga: International Society for Human Rights-ISHR, Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë në RM, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe Fakulteti i Administratës së Biznesit në Kumanovë - Programi studimor-Administratë Publike - Universiteti Shtetëror i Tetovës. Realizimi i një ligjërate - prezantimi publik në Këndin Amerikan në Tetovë, më datë 15 shkurt 2011, kushtuar ditës së Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me titull: "*Pozita dhe Roli i Presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës*". Pjesëmarrja dhe Prezantimi në "Kongresin e 4-t Ndërkombëtarë të Shkencave Sociale në Ballkan", me temën: "*Trajtat e ushtrimit të pushtetit Shtetëror*", mbajtur në Universitetin Shtetëror të Tetovës, më datë 11 dhe 12 shtator, si dhe kryesues i njëres nga seancat e Kongresit përkatës më 12 shtator. Pjesëmarrje në trajnimin ndërkombëtar "*Zgjidhja e konflikteve dhe harmonia sociale*", organizuar nga Instituti hulumtues "Max van der Stoel" në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, në bashkëpunim me Institutin e të Drejtave të Njeriut, Universiteti i Kolumbisë - New York, 25-28 mars 2013. Certifikata nga Universiteti i Kolumbis, Columbia University, New York. 17.06.2013 dhe 24.06.2013, pjesëmarrje në tryezën e rrumbullakët me temë: "*Diskutim mbi analizën kuantitative për statusin e implementimit të politikave të MO-së*", organizuar nga Sekretariati për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit. 24.12.2013, pjesëmarrja në Tribunën shkencore me temë "*Shkollimi i lartë dhe korrupsioni në vendet e ballkanit perëndimor*", organizuar në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë. 25.12.2013, pjesëmarrja në tribunën shkencore "*Kundër dhunës për paqe dhe bashkëjetesë në Republikën e Maqedonisë*", organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës. 22.01.2014, pjesëmarrja në tribunën shkencore "*Çfarë Presidenti i duhet Republikës së Maqedonisë*", organizuar nga Fakulteti Juridik - Universiteti Shtetëror i Tetovës. 28.01.2014, pjesëmarrja në tribunën shkencore "*Propozim-ligji për nëpunësit administrativ*", organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës. 12.03.2014, pjesëmarrës në Konferencën shkencore ndërkombëtare "*Shteti Juridik dhe Demokracia*", organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës. 05.07.2014, pjesëmarrja në: Konferenca e 3-të Akademike Ndërkombëtare mbi Integritet Evropian "*Integrimi i Evropës Juglindore në BE - Sfidat*", mbajtur në komunën e Tetovës, Republika e Maqedonisë, organizuar nga: Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike, Akademia Diplomatike Shqiptare, Tetovë. 11.09.2014, pjesëmarrës në Konferencën Shkencore ndërkombëtare "*Social Change in the Global World*" në Universitetin "Goce Dellçev" në Shtip, me temë: "*Kontrolli dhe Përgjegjësia e Administratës*". 23.09.2014, pjesëmarrja në *debatin shkencor dhe profesional për draft amendamente kushtetutës së Republikës së Maqedonisë*, organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës. 10.10.2014, pjesëmarrës në "*Diskutim lidhur me Raportin e Komisionit Evropian për progresin e Republikës së Maqedonisë për vitin 2014*", organizuar nga Sekretariati për Çështje Evropiane të qeverisë së RM-së, si përfaqësues i Universitetit Shtetëror të Tetovës. 20 janar 2015 - 05 shkurt 2015, i angazhuar si ekspert nga UNDP (United Nations Development), ekspert për të vlerësuar zgjidhjet normative të kapitullit III të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe për të ofruar propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, në ministrinë e vetadministrimit lokal në Republikën e Maqedonisë. Më datë 09 mars 2015, në kuadër të mësimit klinik në lëndën: E drejta kushtetuese krahasuese, ka realizuar ligjëratën me temë: Sistemi kushtetues në Republikën e Kosovës, të ligjëruar nga Prof. dr. Arsim Bajrami - ligjërues në Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës, profesor dhe ekspert i të drejtës kushtetuese njëherësh ish Ministër i arsimit, shkencës dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës. Më datë

14.05.2015, në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup dhe Zyrën për Marrëdhënie Ndërkombëtare në Universitetin Shtetëror të Tetovës ka mundësuar realizimin e një ligjërata nga z.Charlie Wintermeyer-zyrtar i shërbimit të jashtëm të SHBA-ve, me përvojë 16 vjeçare në shumë shtete dhe zyrtar i menaxhmentit për Ambasadën e SHBA-ve në Shkup, i specializuar në lëmin e të drejtës ushtarake, me temë "*Përvojat e SHBA-ve me reformat në administratën shtetërore*". Anëtar i Komitetit Programor Ndërkombëtarë të Konferencës së dytë Shkencore Ndërkombëtare "*Ndryshimet Shoqërore në Botën Globale*", organizuar nga Universiteti "Goce Dellçev", Fakulteti Juridik në Shtip, 2nd International Conference "Social Change in the Global World", Faculty of Law in Shtip, Macedonia, 3-5 September 2015. Pjesëmarrja në ligjëratën dhe tribunën me temë: "*Pajtimi Kombëtar*", organizuar nga Instituti Francez në Shkup, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Aleanca Franceze në Tetovë dhe Ambasada e Francës në Maqedoni, e njëjta është realizuar më datë 11 qershor 2015 në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës, tribuna është udhëhequr nga An Bazen - profesor i shkencave politike në Lil. 03.07.2015, pjesëmarrja në tribunën shkencore "*Diplomacia Amerikane - mbështetëse e çështjes shqiptare*", me temë: "*Tiparet e sistemit amerikan të qeverisjes dhe politikës së jashtme*", organizuar nga Universiteti Shtetëror i Tetovës, tribunë e organizuar për të shënuar Ditën e Pavarësisë së SHBA-ve, 4 korrik 1776. 13-14 Nëntor 2015, anëtarë i Këshillit organizues dhe pjesëmarrës në Konferencën shkencore ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës me temë "*Universalizmi, globalizimi dhe shteti i së drejtës, Universality, globalization and the rule of law, Универзализмот, глобализацијата и правната држава*" me punimin „*Principe of State Power Sharing in the Constitutional Systems*”. 15.01.2016, Pjesëmarrja në Debatin e organizuar nga Ministria e vetadministrimit lokal në Republikën e Maqedonisë me temë: "*Decentralizimi dhe Zhvillimi Rajonal*" me prezantimin: "*Sfidat, të arriturat, vështirësitë dhe prioritetet e decentralizimit në Republikën e Maqedonisë*". 26.01.2016, Pjesëmarrja në emisionin Argument - Debat për KSHZ (Komisionin shtetëror zgjedhor), në Radiotelevizionin e Maqedonisë, Programi 2, Programi në gjuhën shqipe, me temë: "*Pastrimi i listave zgjedhore*". 04.02.2016, Pjesëmarrja në emisionin debativ Rruga drejt.... në Televizionin Alsat M, Republika e Maqedonisë, me temë: "*Metodologjia e KSHZ-së (Komisionit shtetëror zgjedhor) për pastrimin e Listës Zgjedhore*". 23.02.2016, Pjesëmarrja në Panelin Debativ organizuar nga: Këndi Amerikan në Tetovë & Universiteti Shtetëror i Tetovës & Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Maqedonisë, me temë: "*Zgjedhjet në Amerikë & Zgjedhjet në Maqedoni*", me ç'rast ka shtjelluar temën: "*Zgjedhjet në Maqedoni*" (*Dilemat dhe perspektiva e sistemit zgjedhor në Republikën e Maqedonisë*), lidhur me zgjedhjet në SHBA ka prezantuar z. James Stein, Drejtor i Misionit USAID në Maqedoni, paneli debativ është organizuar në Universitetin Shtetëror të Tetovës, në prezencë të udhëheqësisë së universitetit, profesorëve, studentëve, stafit administrativ dhe përfaqësuesve të medieve. 26.04.2016, Pjesëmarrja në Samitin e improvizuar: "*NATO në Sytë e Samitit të Varshavës*", sëbashku me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë, në Shkup. Pjesëmarrja dhe moderimi i tribunës shkencore me temë: "*Ndikimi i proceseve integruese euro-atlantike në marrëdhëniet ndëretnike*", organizuar nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Tetovës dhe Këshilli Euroatlantik i Maqedonisë, realizuar më datë 06.10.2016. 11.10.2016, Pjesëmarrja në emisionin Argument - Debat për Sistemin Zgjedhor dhe sundimin e ligjit në Republikën e Maqedonisë, në Radiotelevizionin e Maqedonisë, Programi 2, Programi në gjuhën shqipe. 14.10.2016, Në Koordinim të përbashkët me shefin e programit studimor të kriminalistikës ka organizuar një ligjëratë për studentët e këtij programi studimor në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës,

nga dy profesorë eminent nga Universiteti i Zagrebit dhe Akademisë Policore të Republikës së Kroacisë, Dr.sc.Josip Pavlicek dhe Dr.sc.Lana Milivojevic, të cilët ligjëruan mbi: *Metodat e zhvillimit të bisedave me personat e dyshuar, mënyrat se si bëhet detektimi i gënjeshtërs gjatë procedurave policore, teknikat që hetuesit kroat i përdorin gjatë zbulimit dhe ndriçimit të veprave penale si dhe për reformat në të drejtën penale që janë realizuar në Republikën e Kroacisë me kërkesë të Unionit Evropian*. 15.10.2016, Prononcim në Televizionin Alsat M, Republika e Maqedonisë, lidhur me *Rolin e komunitetit ndërkombëtar lidhur me realizimin eventual të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në vend dhe parimet të cilat mundësojnë zgjedhje të lira, demokratike dhe të drejtëpërdrejta*. 17.10.2016, Në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Zyrën për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Tetovës, bashkërisht kanë realizuar ligjëratën e Ekspertëve nga sfera e gazetarisë: Barbara Cochran dhe John Cochran, me temë: *"Zgjedhjet në Amerikë dhe mediumet"*. Ligjëratat është realizuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, me pjesëmarrjen e studentëve të gazetarisë, studimeve të drejtësisë, kriminalistikës dhe shkencave politike. Anëtarë i Këshillit organizativ të Konferencës së tretë ndërkombëtare shkencore të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, për datën 18-19 nëntor 2016, me temë: *"Drejtësia dhe Sfidat e Proceseve Euroatlantike"* - *"The Law and Challenges of the Euro-Atlantic Processes"*.

22-23 Nëntor 2016, Pjesëmarrja në Konferencën Regjionale *"Drejtësia Administrative në Ballkanin Perëndimor"*, organizuar nga ReSPA - Shkolla Regjionale e Administratës Publike dhe Gjykatat e Malit të Zi, të financuar nga Bashkimi Evropian (Regional Conference *"Administrative Justice in Western Balkans"*, 22-23 November 2016, Congress Centre Premier, Podgorica Montenegro). 05.12.2016, Pjesëmarrja në ligjëratën me temë: *"Rule of Law and Legal Education in the U.S. Substance of teaching anti-corruption"*, ligjëruar nga Brian D. Anderson (Assistant Director & Assistant Profesor of Law, Ohio Northern University), realizuar në Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup. 06.12.2016, Në bashkëpunim me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shkup, Zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin e Tetovës, kanë realizuar ligjëratën me temë: *"Rule of Law and Legal Education in the U.S. Substance of teaching anti-corruption"*, ligjëruar nga Brian D. Anderson (Assistant Director & Assistant Profesor of Law, Ohio Northern University), ligjëratat është realizuar në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, me pjesëmarrjen e studentëve të shkencave politike, gazetarisë, kriminalistikës dhe studimeve të drejtësisë. 02.03.2017, Pjesëmarrja aktive në Ligjëratën - Takimin e realizuar nga Federica Mogherini, Përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian për punë të jashtme dhe politikë të sigurisë dhe zv.Presidente e Komisionit Evropian, realizuar në Shkup, pjesëmarrja është realizuar sëbashku me studentët nga Universiteti i Tetovës, duke përfaqësuar institucionin përkatës. 30.03.2017, Pjesëmarrja dhe udhëheqja me Debatin Publik, me temë: *"Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për pengimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, organizuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të Republikës së Maqedonisë, OSBE misionit në Maqedoni dhe Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës"*. 01-03.10.2017, Pjesëmarrja në Konferencën Shkencore "Lëvizja Studentore në Kosovë dhe Protesta e 1 Tetorit 1997", me temë: *"Arsimimi, demokracia dhe shteti ligjor"*. Organizuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti Filozofik, Prishtinë. 12.10.2017, Pjesëmarrja dhe moderimi i Tribunës me temë: *"Të drejtuarit e dialogut rinor në promovimin e demokracisë në dritën e integritetit euroatlantik"*, *"Straightening the youth dialogue for democracy promotion in the light of Euro-Atlantic integration"*, organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë në partneritet me Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës. 02.11.2017, Prezantim profesional në Televizionin Koha Tetovë lidhur me Trajtat e qeverisjes

dhe rolin e administratës shtetërore-publike. 09.11.2017, Prezantim profesional në emisionin debativ "Zig-Zag" në Art Chanell Tetovë, "*Zgjedhjet Lokale 2017 në Republikën e Maqedonisë*". 17.11.2017, Pjesëmarrja dhe Anëtarë i Këshillit Organizativ të Konferencës së IV Ndërkombëtare të Fakultetit Juridik në Universitetin e Tetovës, me temë: "*Security Challenges and Universal Standards in the Euro-Atlantik Integration Process*", "*Sfidat e Sigurisë dhe Standardet Universale në Procesin e Integritimit Euro-Atlantike*". 08.12.2017, Pjesëmarrja në Tryezën shkencore të organizuar nga Akademia e Arteve dhe e Shkencave të Republikës së Kosovës, me temë: "*Sfidat e ndërtimit të Shtetit të së Drejtës, Rasti i Maqedonisë*".

Listë e punimeve shkencore dhe botimeve profesionale të publikuara

-"***Ndërtimi i Shtetit Ligjor me Vështrim të Veçantë në Republikën e Maqedonisë***", E drejta-Law, Revistë për çështje juridike dhe shoqërore-Journal for juridical and social issues, viti XXXIV- nr. 1-4/2009, botues-Publisher Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës- Law school of University of Prishtina;

-"***Sistemi Parlamentar në Republikën e Maqedonisë***", Përmbledhje e punimeve shkencore nga konferenca ndërkombëtare shkencore juridike, Tetovë, dhjetor 2008, botues Luma Grafik, Tetovë;

-"***Reformat në Administratën Publike në Republikën e Maqedonisë si një nga Kriteret Politike për Anëtarësim në Bashkimin Evropian***", ULPIANUS – Revistë shkencore dhe profesionale juridike, nr.1/2011, Tetovë, dhjetor 2011, Shoqata e juristëve shqiptarë të Maqedonisë, Forumi shkencor-hulumtues;

-"***Raportet mes pushtetit ligdhënës, ekzekutiv dhe gjyqësor në Republikën e Maqedonisë***", Vizione - Revistë e shkencave shoqërore, Nr.17, Botues: Shoqata e Intelektualëve "Klubi Demokratik"-Shkup. Publisher: The Association of Intellectuals "Democratic Club" - Skopje, Shkup, 15 Dhjetor - December 2011;

-"***Sfidat dhe Dilemat e Sistemit Zgjedhor dhe Politik në Republikën e Maqedonisë***" CONSTITUTIO, nr.1/2012, revistë studimore për çështje juridiko-kushtetuese dhe parlamentare, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare në Republikën e Kosovës botuar në numrin tematik Kompetencat dhe roli i Presidentit në përcaktimin e modelit të Qeverisjes në Republikë - Mësimet dhe përvojat regjionale, nr.1, 2012;

-"***Veçoritë e Sistemit Amerikan të Qeverisjes***", Revista Shqiptare Social Ekonomike, viti i XVIII, nr.1 (70) 2012, Qendra Shqiptare për Kërkime Ekonomike – Albanian Socio Ekonomik Review - ACER, Revistë Ekonomike Tremujore, Tiranë 2012;

-"***Modelet e Mbrotjtjes së Kushtetutshmërisë -aspekte krahasuese-***", ULPIANUS-Revistë shkencore dhe profesionale juridike, nr.2/2012, Tetovë, Maj 2012, Shoqata e juristëve shqiptarë të Maqedonisë, Forumi shkencor-Hulumtues;

-"***Pozita juridiko - kushtetuese e bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë***", CONSTITUTIO, nr.2/2012, revistë studimore për çështje juridiko-kushtetuese dhe parlamentare, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare në Republikën e Kosovës, nr.2, 2012;

-"***Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Organizmi dhe Veprimtaria***", Vizione - Revistë e shkencave shoqërore, nr.19, Botues: Shoqata e Intelektualëve "Klubi Demokratik"-Shkup. Publisher: The Association of Intellectuals "Democratic Club" - Skopje, Shkup, 2013;

-"***Demokracia dhe Vetadministrimi Lokal***", Justicia, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, nr.1, Tetovë, 2013;

- "Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë"***, libër universitar, botuar në maj 2013, botues: Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Juridik, shtypur nga ArbëriaDesign. Recensentë: Prof.dr.Arsim Bajrami, Prof.dr.Gjyljeta Mushkolaj, Prof.dr.Mersim Maksuti. Komisioni për veprimtari botuese i Universitetit Shtetëror të Tetovës e lejoi botimin dhe përdorimin e këtij teksti universitar me Vendimin nr. 02-2957/1 të datës 21.05.2013;
- "Trajtat e Ushtrimit të Pushtetit Shtetëror"***, DISKUTIME, Revistë shkencore ndërkombëtare, viti II - nr. 8 - 22 Nëntor 2013 - www.diskutime.org, print: ISSN 1857-825X, online: ISSN 1857-8543;
- "Rregullimi Kushtetues në Republikën e Maqedonisë"***, CONSTITUTIO, 3 & 4 - 2013, revistë studimore për çështje juridiko-kushtetuese dhe parlamentare, botim i Institutit për Studime Kushtetuese dhe Parlamentare në Republikën e Kosovës;
- "Organizimi dhe Përgjegjësitë e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë"***, Justicia, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, nr.1/2014, Vol.2, Tetovë, 2014;
- "Sistemi Gjyqësorë në Republikën e Maqedonisë - sfidat dhe dilemat"***, DISKUTIME, Revistë shkencore ndërkombëtare, viti III - nr. 12, Vëllimi - 3 - Korrik 2014 - www.diskutime.org, Botimi i shtypur: ISSN 1857-825X, Botimi elektronik:ISSN 1857- 8543;
- "Control and Responsibility of Administration According to the Positive Legislation of the Republic of Macedonia"***, Сборник на Трудови (Proceedings), Center for Legal and Political Research, Faculty of Law, Goce Delcev University in Shtip, Republic of Macedonia, First International Scientific Conference - Општествените Промени во Глобалниот Свет - Social Change in the Global World, Shtip 2014;
- "E Drejta Administrative"***, libër universitar, botuar në Janar 2015, botues: Universiteti "Haxhi Zeka" Fakulteti Juridik - Pejë, Republika e Kosovës. Recensentë: Prof.dr.Agur Sokoli, Prof.dr.Mirlinda Batalli, Prof.dr.Evis Alimehmeti. Këshilli botues i Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë, e lejoi botimin dhe përdorimin e këtij teksti universitar meVendimin nr. 1782 të datës 11.12.2014;
- "Pozita Kushtetuese dhe Ligjore e Pakicave Kombëtare - Aspekte Krahase"***, autorë: Arsim Bajrami, Zenun Halili, Jusuf Zejneli, Florent Muçaj. Studimi u mundësua nga fondi për shkencë i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës -MASHT i vitit 2014. Botime ARTINI. Recensent: Esat Stavileci, Aurela Anastasi;
- "Atributet e Shtetit Ligjor dhe Demokracisë"***, Justicia, International Journal of Legal Sciences, 2/2014, Justicia I Vol.2 I No.2 I pp.1-232 I Faculty of Law, State University of Tetova, Republic of Macedonia, Tetova 2014, UDC: 34, ISSN 1857 - 8454 (Print);
- "The Role of the Working Bodies in the Parliamentary Democracy"*** – VIZIONE, International magazine for social sciences, UDC 316, 33, 32, nr. 24, ISSN 1409-8962, ISSN 1857-9221, Shkup 2015;
- "Political System In The Republic of Macedonia And EU - NATO Membership Challenges"***, European Scientific Journal Maj 2016 edition vol 12, No. 14 ISSN:1857-7881 (Print) e-ISSN 1857-7431;
- "Tiparet e Sistemit Amerikan të Qeverisjes dhe Politikës së Jashtme"*** - JURIDICA, Revistë për studime juridike dhe shoqërore, Magazine for legal and social studies, K.D.U. 34 (05), ISSN: 1409-8962, ISSN:1857-9221, Nr. 5, Prishtinë 2016;
- "Parimi i Ndarjes së Pushtetit Shtetëror në Sistemet Kushtetuese (Principe of State Power Sharing in the Constitutional Systems)"***, JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, nr.5/2016, Vol.4, Tetovë 2016 (Justicia, International Journal of Legal Sciences, Vol.4

I No.5 I pp.1-202 I Faculty of Law, University of Tetova, Republic of Macedonia, Tetova 2016, UDC: 34, ISSN 1857 - 8454 (Print);

-*"Administrata si pushtet apo shërbim (Administration: executive either service)"*, JUSTICIA, Revistë e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, nr.7/2017, Vol.5, Tetovë 2017 (Justicia, International Journal of Legal Sciences, Vol.5 I No.7 I pp.1-212 I Faculty of Law, University of Tetova, Republic of Macedonia, Tetova 2017, UDC: 34, ISSN 1857 - 8454 (Print).

Nr.	Referencat profesionale të kandidatit për zgjedhjen në thirrje	Pikët
1.	Veprimtaria mësimore-shkencore	85.13
2.	Veprimtaria shkencore-hulumtuese	89
3.	Veprimtaria profesionale-aplikative	26
4.	Veprimtaria me interes më të gjerë	92
	Gjithsej	292.13

VLERËSIM DHE PROPOZIM

Në bazë të konstatimeve të lartpërmendura, Komisioni recensues vlerëson se kandidati **Doc.dr.Jusuf Zejneli** i plotëson të gjitha kushtet e nevojshme për zgjedhje në thirrjen mësimore-shkencore **Inordinar**, duke u referuar në përvojën e deritanishme profesionale dhe pedagogjike. Duke marrë parasysh aktivitetin gjithpërfshirës të kandidatit nga sfera e të drejtës, si dhe kontinuitetin në studimet dhe thirrja docent nga fusha përkatëse, pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare, projekte hulumtuese, të arriturat shkencore të prezantuara në disertacionin e doktoraturës, punimin e magistraturës, punimet shkencore dhe profesionale të publikuara, Komisioni vlerëson se **Doc.dr.Jusuf Zejneli** i plotëson të gjitha kushtet për thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**, sipas kriterëve të përcaktuara me Ligjin për Arsim të Lartë, Statutin e Universitetit të Tetovës dhe Rregulloren për kriteret e veçanta dhe procedurën për zgjedhje-rizgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, mësimore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës.

Komisioni recensues ka nderin t'i propozojë Këshillit Mësimor-Shkencor të Fakultetit Juridik dhe Këshillit të Rektoratit të Universitetit të Tetovës, që **Doc.dr.Jusuf Zejneli** të zgjidhet Profesor për lëndët: **"Teoria dhe praktika parlamentare"**, **"E drejta administrative"** dhe **"E drejta kushtetuese krahasuese"** në Fakultetin Juridik në Universitetin e Tetovës, në thirrjen mësimore-shkencore **Profesor Inordinar**.

Komisioni Recensues:

1. **Prof. Dr. Arsim Bajrami**, kryetar

2. **Prof. Dr. Mersim Maksuti**, anëtar

3. Prof. Dr. Fatmire Lumani, anëtar

Tetovë, 2018

SHTOJCË PËR RAPORTIN PËR ZGJEDHJEN NË THIRRJEN MËSIMORE-SHKENCORE DHE MËSIMORE-PROFESIONALE

Kandidati: **Doc. Dr. Jusuf Zejneli**

Institucioni: **Universiteti i Tetovës, Fakulteti Juridik**

Lëndët: **“Teoria dhe praktika parlamentare”, “E drejta administrative” dhe**

“E drejta kushtetuese krahasuese”

Titulli: Titulli në bazë të konkursit të shpallur - **Profesor Inordinar**

VEPRIMTARIA MËSIMORE SHKENCORE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Mbajtja e Ligjeratave	
I.1	Teoria dhe praktika parlamentare (2+1, Tetovë, 4 semestra)	$2 \times 15 \times 4 \times 0.04 = 4.8$
I.2	Teoria dhe praktika parlamentare (2+1, Shkup, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
I.3	E drejta administrative (3+1, Shkup, 1 semestër)	$3 \times 15 \times 1 \times 0.04 = 1.8$
I.4	E drejta kushtetuese krahasuese (2+1, Shkup, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
I.5	E drejta kushtetuese krahasuese (2+1, Tetovë, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.04 = 3.6$
I.6	Bazat e sistemit gjyqësor (2+1, Tetovë, 2 semestra)	$2 \times 15 \times 2 \times 0.04 = 2.4$
I.7	E drejta e procedurës administrative (Cikli Master, 3+1, 3 semestra)	$3 \times 15 \times 3 \times 0.05 = 6.7$
I.8	Përgjegjësitë në administratën publike (Cikli Master, 2+1, 3 semestra)	$2 \times 15 \times 3 \times 0.05 = 4.5$
I.9	Administratë publike e krahasuar (Cikli Master, 3+1, 1 semestër)	$3 \times 15 \times 1 \times 0.05 = 2.2$
I.10	E drejta administrative, program i aplikuar (Cikli Master, 3+1, 3 semestra)	$3 \times 15 \times 3 \times 0.05 = 6.7$
II	Mbajtja e Konsultimeve	
II.1	Teoria dhe praktika parlamentare (2+1, Tetovë, 4 semestra)	$20 \times 4 \times 0.002 = 0.16$
II.2	Teoria dhe praktika parlamentare (2+1, Shkup, 3 semestra)	$15 \times 3 \times 0.002 = 0.09$
II.3	E drejta administrative (3+1, Shkup, 1 semestër)	$5 \times 1 \times 0.002 = 0.01$
II.4	E drejta kushtetuese krahasuese (2+1, Shkup, 2 semestra)	$10 \times 2 \times 0.002 = 0.04$
II.5	E drejta kushtetuese krahasuese (2+1, Tetovë, 3 semestra)	$15 \times 3 \times 0.002 = 0.09$
II.6	Bazat e sistemit gjyqësor (2+1, Tetovë, 2 semestra)	$10 \times 2 \times 0.002 = 0.04$
III	Mentor i Punimeve të Masterit	
	Mentorim i punimeve të Masterit	$8 \times 3 = 24$
IV	Anëtarë në Komisione për Mbrojtjen e Punimeve të Masterit dhe Doktoraturës	
	Anëtar në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të Masterit	$8 \times 1 = 8$

	Kryetarë në komisione për vlerësim dhe mbrojtje të punimit të Masterit	7x2=14
	Gjithsej:	85.13

VEPRIMTARIA SHKENCORE-HULUMTUESE

Nr. Rendor	Emri i aktivitetit	Pikët
I	Pjesëmarrje në Projekte Shkencore	
I.1	22-23 Nëntor 2016, Pjesëmarrja në Konferencën Regjionale <i>"Drejtësia Administrative në Ballkanin Perëndimor"</i> , organizuar nga ReSPA - Shkolla Regjionale e Administratës Publike dhe Gjykatat e Malit të Zi, të financuar nga Bashkimi Evropian (Regional Conference <i>"Administrative Justice in Western Balkans"</i> , 22-23 November 2016, Congress Centre Premier, Podgorica Montenegro)	3
I.2	20 janar 2015 - 05 shkurt 2015, <i>i angazhuar si ekspert nga UNDP (United Nations Development)</i> , ekspert për të vlerësuar zgjidhjet normative të kapitullit III të Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal dhe për të ofruar propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal, në ministrinë e vetadministrimit lokal në RM	3
I.3	26.04.2016, Pjesëmarrja në Samitin e improvizuar: <i>"NATO në Sytë e Samitit të Varshavës"</i> , sëbashku me studentët e Fakultetit Juridik të Universitetit të Tetovës, organizuar nga Këshilli Euro-Atlantik i Maqedonisë, në Shkup	3
II	Artikuj me Rezultate Shkencore Origjinale, të Publikuara në Revistë Referente Shkencore / Profesionale me Bord Redaktues Ndërkombëtar	
II.1	<i>„Political System In The Republic of Macedonia And EU - NATO Membership Challenges"</i> , European Scientific Journal Maj 2016 edition vol 12, No. 14 ISSN:1857-7881 (Print) e-ISSN 1857-7431	6
